

---

**RREGULLORE (KE) NR. 562/2006 E PARLAMENTIT EVROPIAN DHE E  
KËSHILLIT, DATË 15 MARS 2006, "PËR KRIJIMIN E KODIT TË KOMUNITETIT  
PËR RREGULLAT QË RREGULLOJNË LËVIZJEN E PERSONAVE PËRMES  
KUFIJVE (KODI PËR KUFIJTË E SHENGENIT)"**

PARLAMENTI EVROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Evropian dhe, në veçanti, neni 62, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, germa "a" të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të traktatit<sup>1</sup>,

Meqë:

1. Miratimi i masave në zbatim të nenit 62, paragrafi 1 të traktatit me qëllim që të garantohet mungesa e çdo kontrolli për personat që kalojnë kufijtë ndërkombëtar është pjesë e objektivit të BE-së për krijimin e një zone pa kufij të brendshëm ku garantohet lëvizja e lirë e personave, siç përcaktohet në nenin 14 të traktatit.

2. Në përputhje me nenin 61 të traktatit, krijimi i një zone ku personat mund të lëvizin lirshëm duhet të shoqërohet me masa të tjera. Një masë e tillë është politika e përbashkët për kalimin e kufijve të jashtëm, siç parashikohet në nenin 62, paragrafi 2 të traktatit.

3. Miratimi i masave të përbashkëta për kalimin e kufijve të brendshëm nga personat dhe për kontrollin kufitar në kufijtë e jashtëm duhet të pasqyrojë tërësinë e legjislacionit të Shengenit të përfshirë në kuadrin e Bashkimit Evropian, dhe në veçanti dispozitat përkatëse të Konventës për zbatimin e Marrëveshjes Shengen të 14 qershorit 1985 ndërmjet qeverive të shteteve të Bashkimit Ekonomik të Beneluksit, Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Francës për shfuqizimin gradual të kontrolleve në kufijtë e tyre të përbashkët<sup>2</sup> dhe Manualin e Përbashkët<sup>3</sup>.

4. Për sa i përket kontrollit në kufijtë e jashtëm, krijimi i një "korpusi të përbashkët" legjislacioni, veçanërisht nëpërmjet konsolidimit dhe zhvillimit të tërësisë së legjislacionit, është një nga komponentët thelbësorë të politikës së përbashkët për menaxhimin e kufijve të jashtëm, siç përcaktohet në Komunikatën e Komisionit të 7 majit 2002 "Drejt menaxhimit të integruar të kufijve të jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian". Kjo objektivë është përfshirë në "Planin për menaxhimin e kufijve të jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian", miratuar nga Këshilli më 13 qershor 2002 dhe miratuar nga Këshilli Evropian i Seviljes më 21 dhe 22 qershor 2002 dhe nga Këshilli Evropian i Selanikut i 19 dhe 20 qershorit 2003.

5. Përkufizimi i rregullave të përbashkëta për lëvizjen e personave përmes kufijve nuk vë në diskutim dhe nuk prek të drejtat për lëvizjen e lirë që gëzojnë qytetarët e Bashkimit Evropian

dhe anëtarët e familjeve të tyre, si dhe shtetasit e vendeve të treta dhe anëtarët e familjeve të tyre, të cilët, në zbatim të marrëveshjeve ndërmjet Komunitetit dhe shteteve të tij anëtare, nga njëra anë, dhe këtyre vendeve të treta, nga ana tjetër, gëzojnë të drejtat e lëvizjes së lirë të barasvlershme me ato të qytetarëve të Bashkimit Evropian.

6. Kontrolli kufitar nuk është vetëm në interes të shtetit anëtar në kufijtë e jashtëm të të cilit ai ushtrohet, por edhe të të gjithë shteteve anëtare që kanë hequr kontrollin në kufijtë e brendshëm. Kontrolli kufitar duhet të ndihmojë në luftën kundër imigrimit të paligjshëm dhe trafikimit të qenieve njerëzore dhe në parandalimin e kërcënimeve ndaj sigurisë së brendshme, politikave publike, shëndetit publik dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të shteteve anëtare.

7. Verifikimet kufitare duhet të kryhen në respektim të plotë të dinjitetit njerëzor. Kontrolli kufitar duhet të kryhet në mënyrë profesionale dhe të respektueshme dhe të jetë proporcional me objektivat e kërkuara.

8. Kontrolli kufitar përfshin jo vetëm verifikimin e personave në pikat e kalimit kufitar dhe mbikëqyrjen ndërmjet këtyre pikave të kalimit kufitar por edhe një analizë të rreziqeve për sigurinë e brendshme dhe analizë të kërcënimeve që mund të cenojnë sigurinë e kufijve të jashtëm. Ndaj, duhet të përcaktohen kushtet, kriteret dhe rregullat e detajuara që rregullojnë verifikimet në pikat e kalimit kufitar dhe mbikëqyrjen.

9. Duhet të merren masa për lehtësimin e verifikimeve në kufijtë e jashtëm në rastin e rrethanave të veçanta dhe të paparashikueshme me qëllim për të shmangur kohën e gjatë të pritjes në pikat e kalimit kufitar. Vulosja sistematike e dokumenteve të shtetasve të vendeve të treta mbetet një detyrim edhe në rastin e verifikimeve kufitare të lehtësuara. Vulosja mundëson përcaktimin me siguri të datës dhe vendit ku është kaluar kufiri, pa përcaktuar për të gjitha rastet se janë zbatuar të gjitha masat e kërkuara për kontrollin e dokumenteve të udhëtimit.

10. Për të ulur kohën e pritjes për personat që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë, në pikat e kalimit kufitar, aty ku e lejojnë rrethanat, duhet të ofrohen korsitë të veçanta që mbajnë tabela unifrome në të gjitha shtetet anëtare. Korsitë e veçanta duhet të vendosen në aeroportet ndërkombëtare. Aty ku konsiderohet e përshtatshme dhe ku e lejojnë rrethanat lokale, shtetet anëtare duhet të marrin në konsideratë vendosjen e korsive të veçanta në pikat e kalimit kufitar në det dhe në tokë.

11. Shtetet anëtare duhet të sigurohen që procedurat e kontrollit në kufijtë e jashtëm të mos përbëjnë një barrierë për shkëmbimet tregtare, sociale dhe kulturore. Për këtë qëllim, ata duhet të vënë në dispozicion një numër të përshtatshëm personeli dhe burimesh.

12. Shtetet anëtare duhet të emërojnë shërbimin ose shërbimet kombëtare përgjegjëse për detyrat e kontrollit kufitar, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm. Kur në të njëjtin shtet anëtar ka më shumë se një shërbim përgjegjës, ndërmjet tyre duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm.

13. Bashkëpunimi dhe asistenca operacionale ndërmjet shteteve anëtare në lidhje me kontrollin kufitar duhet të menaxhohet dhe koordinohet nga Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare, e themeluar me anë të Rregullores (KE) nr. 2007/2004<sup>4</sup>.

14. Kjo rregullore nuk cenon verifikimet që kryhen sipas kompetencave të përgjithshme të policisë dhe verifikimeve që lidhen me sigurinë për personat, të cilat janë identike me verifikimet që kryhen për fluturimet e brendshme, mundësitë që shtetet anëtare të kryejnë verifikime të veçanta të bagazhit në përputhje me Rregulloren e Këshillit (KEE) nr. 3925/91, datë 19 dhjetor 1991, "Për eliminimin e kontrolleve dhe formaliteteve të kontrollit të bagazhit të ekuipazhit dhe bagazhit të dorës së personave që marrin fluturime brenda Komunitetit dhe të bagazhit të personave që kalojnë kufijtë detarë brenda Komunitetit"<sup>5</sup>, apo legjisllacionin e brendshëm për të mbajtur me vete dokumente udhëtimi ose identifikimi ose për kërkesën që personat të njoftojnë autoritetet për praninë e tyre në territorin e shtetit anëtar në fjalë.

15. Gjithashtu, shtetet anëtare duhet të kenë mundësi që të rinisin zbatimin e përkohshëm të kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm në rastin e një kërcënimi serioz për politikën e tyre publike ose sigurinë e brendshme. Kushtet dhe procedurat për diçka të tillë duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të garantojnë se çdo masë e tillë është e veçantë dhe se respektohet parimi i proporcionalitetit. Qëllimi dhe kohëzgjatja e çdo rinisjeje të përkohshme të kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm duhet të kufizohet deri në minimumin e domosdoshëm për t'iu përgjigjur një kërcënimi të tillë.

16. Në një zonë ku personat mund të lëvizin lirisht, rivendosja e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm duhet të mbetet një përjashtim. Kontrolli kufitar nuk duhet të kryhet ose formalitetet nuk duhet të vendosen vetëm për shkak të kalimit të këtyre kufijve.

17. Duhet të parashikohet një procedurë që i mundëson Komisionit të miratojë disa rregulla praktike të detajuara që rregullojnë kontrollin kufitar. Në këto raste, masat që nevojiten për të zbatuar këtë rregullore duhet të merren në zbatim të Vendimit të Këshillit 1999/468/KE, datë 28 qershor 1999, "Për përcaktimin e procedurave për ushtrimin e kompetencave zbatuese që i janë deleguar Komisionit"<sup>6</sup>.

18. Duhet të parashikohet edhe një procedurë që i mundëson shteteve anëtare që të njoftojnë Komisionin për ndryshimet e rregullave të tjera praktike të detajuara që rregullojnë kontrollin kufitar.

19. Meqenëse objektivat e kësaj rregulloreje, përkatësisht, përcaktimi i rregullave të zbatueshme për lëvizjen e personave përmes kufijve nuk mund të arrihet siç duhet nga shtetet anëtare dhe, për pasojë, mund të arrihet më mirë në nivel Komuniteti, Komuniteti mund të miratojë masa në përputhje me parimin e subsidiaritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të traktatit. Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, sipas përcaktimit në atë nen, kjo rregullore nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e këtij objekti.

20. Kjo rregullore respekton të drejtat themelore dhe parimet e njohura në veçanti nga Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian. Ajo duhet të zbatohet në përputhje me detyrimet e shteteve anëtare që lidhen me mbrojtjen ndërkombëtare dhe moskthimin.

21. Duke deroguar nga neni 299 i traktatit, territoret franceze dhe holandeze për të cilat zbatohet kjo rregullore janë vetëm ato që ndodhen në Evropë. Ajo nuk ndikon në marrëveshjet specifike që zbatohen në Seuta dhe Melijë, siç përcaktohet në Marrëveshjen për Anëtarësimin e Mbretërisë së Spanjës në Konventën që zbaton Marrëveshjen e Shengenit të 14 qershorit 1985<sup>7</sup>.

22. Në përputhje me nenet 1 dhe 2 të Protokollit për qëndrimin e Danimarkës, bashkëlidhur si shtojcë në Traktatin për Bashkimin Evropian dhe Traktatin themelues të Komunitetit Evropian, Danimarka nuk merr pjesë në miratimin e kësaj rregulloreje dhe nuk ka detyrime prej saj dhe as nuk i nënshtrohet zbatimit të saj. Duke qenë se kjo rregullore bazohet në tërësinë e legjislacionit të Shengenit, sipas dispozitave të titullit IV të pjesës tre të Traktatit themelues të Komunitetit Evropian, Danimarka, në përputhje me nenin 5 të këtij protokollit, vendos brenda një periudhe gjashtë mujore pas datës së miratimit të kësaj rregulloreje, nëse ajo do ta zbatojë ose jo atë në legjislacionin e saj të brendshëm.

23. Për sa i përket Islandës dhe Norvegjisë, kjo rregullore përbën një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë për asociimin e këtyre të fundit në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit<sup>8</sup> të Shengenit, të cilat përfshihet në fushën e përmendur në nenin 1, pika A, të Vendimit të Këshillit 1999/437/KE<sup>9</sup> për disa rregulla lidhur me zbatimin e marrëveshjes.

24. Për të lejuar që përfaqësuesit e Islandës dhe Norvegjisë të mund të lidhen me punën e komiteteve që ndihmojnë Komisionin në ushtrimin e kompetencave të tij zbatuese duhet bërë një marrëveshje. Një marrëveshje e tillë është parashikuar në shkëmbimet e shkresave ndërmjet Këshillit të Bashkimit Evropian dhe Republikës së Islandës dhe Mbretërisë së Norvegjisë në lidhje me komitete që ndihmojnë Komisionin Evropian në ushtrimin e kompetencave të tij ekzekutive<sup>10</sup>, bashkëlidhur marrëveshjes së lartpërmendur.

25. Për sa i përket Zvicrës, kjo rregullore përfaqëson një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit sipas kuptimit që i jepet në marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane në lidhje me përfshirjen e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit, që përfshihen në fushën që përmendet në nenin 1, pika "a" të Vendimit 1999/437/KE që interpretohet së bashku me nenin 4, paragrafi 1, të vendimeve të Këshillit 2004/849/KE<sup>11</sup> dhe 2004/860/KE<sup>12</sup>.

26. Duhet të përgatitet një marrëveshje që u lejon përfaqësuesve Zvicrës që të asociohen në punën e komiteteve që ndihmojnë Komisionin në ushtrimin e kompetencave të tij zbatuese. Kjo marrëveshje është parashikuar në letërkëmbimin midis Komunitetit dhe Zvicrës, bashkëngjitur marrëveshjes së lartpërmendur.

27. Kjo rregullore përfaqëson një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, ku Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë, në përputhje me Vendimin e Këshillit 2000/365/KE, datë 29 maj 2000, "Për kërkesën e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut për të marrë pjesë në disa prej dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit<sup>13</sup>. Ndaj, Mbretëria e Bashkuar nuk merr pjesë në miratimin e kësaj rregulloreje, dhe nuk ka detyrime prej saj dhe as nuk i nënshtrohet zbatimit të saj.

28. Kjo rregullore përfaqëson një zhvillim të dispozitave të tërësisë së legjislacionit të Shengenit, ku Irlanda nuk merr pjesë, në përputhje me Vendimin e Këshillit 2002/192/KE, datë 28 shkurt 2002, "Për kërkesën e Irlandës për të marrë pjesë në disa prej dispozitave të tërësisë së

legjislacionit të Shengenit<sup>14</sup>. Ndaj, Irlanda nuk merr pjesë në miratimin e kësaj rregulloreje, dhe nuk ka detyrime prej saj dhe as nuk i nënshtrohet zbatimit të saj.

29. Në këtë rregullore, fjalia e parë e nenit 1, neni 5, paragrafi 4, germa "a", titulli II dhe shtojcat e saj që i referohen Sistemit Informativ Shengen (SIS) përfaqësojnë dispozita që bazohen në tërësinë e legjislacionit të Shengenit, ose që lidhen me të, sipas kuptimit të nenit 3, paragrafi 2 të Aktit të Anëtarësimit të vitit 2003.

MIRATOJNË KËTË RREGULLORE:

## TITULLI I

### DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1

#### **Objekti dhe parimet**

Kjo rregullore parashikon mungesën e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufijtë e brendshëm ndërmjet shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Ajo përcakton rregullat që rregullojnë kontrollin kufitar të personave që kalojnë kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

#### Neni 2

#### **Përkufizime**

Për qëllimet e kësaj rregulloreje përdoren përkufizimet e mëposhtme:

1. "Kufij të brendshëm" janë:

a) kufijtë e përbashkët tokësorë, duke përfshirë kufijtë lumorë dhe liqenorë, të shteteve anëtare;

b) aeroportet e shteteve anëtare për fluturime të brendshme;

c) portet detare, lumore dhe liqenore të shteteve anëtare për linjat e rregullta me traget;

2. "Kufij të jashtëm" janë kufijtë tokësorë të shteteve anëtare, duke përfshirë kufijtë lumorë dhe liqenorë, kufijtë detarë dhe aeroportet e tyre, portet lumore, portet detare dhe portet liqenore, me kusht që të mos jenë kufij të brendshëm;

3. "fluturim i brendshëm" është çdo fluturim ekskluzivisht drejt ose nga territoret e shteteve anëtare dhe që nuk ulet në territorin e një vendi të tretë;

4. "Linjë e rregullt me traget" është çdo linjë me traget ndërmjet dy ose më shumë porteve të njëjta që ndodhen në territorin e shteteve anëtare, e cila nuk ndalon në asnjë port jashtë

territorit të shteteve anëtare dhe që përbëhet nga transporti i udhëtarëve dhe i automjeteve, sipas një orari të publikuar;

5. "persona që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë" janë:

a) Qytetarët e Bashkimit Evropian sipas nenit 17, paragrafi 1 të traktatit dhe shtetasit e vendeve të treta që janë pjesëtarë të familjes së një qytetari të Bashkimit Evropian, i cili ushtron të drejtën e tij të lëvizjes së lirë, për të cilin zbatohet Direktiva 2004/38/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 29 prillit 2004, "Për të drejtën e qytetarëve të BE-së dhe familjarëve të tyre për të lëvizur dhe banuar lirshëm brenda territorit të shteteve anëtare"<sup>15</sup>;

b) Shtetasit e vendeve të treta dhe pjesëtarët e familjeve të tyre, cilado qoftë kombësia e tyre, të cilët, sipas marrëveshjeve të lidhura ndërmjet Komunitetit dhe shteteve të tij anëtare, nga njëra anë, dhe këtyre vendeve të treta nga ana tjetër, gëzojnë të drejtën e lëvizjes së lirë të barasvlershme me atë të qytetarëve të BE-së;

6. "shtetas i një vendi të tretë" është çdo person, i cili nuk është qytetar i Bashkimit Evropian, sipas kuptimit të nenit 17, paragrafi 1 të traktatit, dhe i cili nuk mbulohet nga pika 5 e këtij neni;

7. "persona për të cilët është nxjerrë një sinjalizim me qëllim refuzimin e hyrjes" është cilido shtetas i vendeve të treta për të cilin është nxjerrë një sinjalizim në Sistemi Informativ Shengen (SIS), në përputhje me dhe për qëllimet e përcaktuara në nenin 96 të Konventës Shengen;

8. "Pikë e kalimit kufitar" është çdo pikë kalimi e autorizuar nga autoritetet kompetente për të kaluar kufijtë e jashtëm;

9. "Kontroll kufitar" është veprimtaria që kryhet në kufi, në përputhje me dhe për qëllimet e kësaj rregulloreje, vetëm në përgjigje të një synimi për të kaluar ose të aktit të kalimit të këtij kufiri, pavarësisht ndonjë gjykimi tjetër, e cila përbëhet nga verifikimet kufitare dhe mbikëqyrja e kufirit;

10. "verifikime kufitare" janë verifikimet që kryhen në pikat e kalimit kufitar për të garantuar se personat, duke përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të autorizohen të hyjnë në territorin e shteteve anëtare ose të dalin prej tij;

11. "mbikëqyrje kufitare" është mbikëqyrja që kryhet në segmentet e kufirit shtetëror midis pikave të kalimit kufitar dhe mbikëqyrja që kryhet në pikën e kalimit kufitar, jashtë orarit zyrtar, me qëllim që personat të mos shmangin verifikimet kufitare;

12. "verifikim i vijës së dytë" është një verifikim i mëtejshëm, i cili mund të kryhet në një vend të posaçëm, larg vendndodhjes në të cilën kryhen verifikimet për të gjithë personat (vija e parë);

13. "roja kufitare" është çdo punonjës publik i caktuar, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, në një pikë të kalimit kufitar, ose përgjatë apo në afërsi të kufirit shtetëror, për të

kryer detyra të kontrollit kufitar, në përputhje me këtë rregullore dhe me legjislacionin e brendshëm;

14. "transportues" është çdo person fizik ose juridik, profesioni i të cilit është të ofrojë transportin e personave;

15. "Leje qëndrimi" është:

a) Të gjitha lejet e qëndrimit të lëshuara nga shtetet anëtare sipas formatit uniform të përcaktuar nga Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1030/2002, datë 13 qershor 2002, që përcakton formatin uniform të lejeve të qëndrimit për shtetasit e vendeve të treta<sup>16</sup>;

b) të gjitha dokumentet e tjera që një shtet anëtar lëshon për shtetasit e vendeve të treta, të cilat autorizojnë qëndrimin në, ose kthimin në territorin e tij, me përjashtim të lejeve të përkohshme që lëshohen në pritje të shqyrtimit të aplikimit të parë për leje qëndrimi, siç përmendet në germën "a", ose të aplikimit për azil;

16. "anije turistike" është një anije e cila ndjek një itinerar të caktuar në përputhje me një program të paracaktuar, që përfshin një program të veprimtarive turistike në porte të ndryshme dhe e cila normalisht nuk merr udhëtarë gjatë udhëtimit dhe as nuk lejon udhëtarët të zbresin gjatë udhëtimit;

17. "lundrim argëtues" është përdorimi i varkave argëtuese për qëllime sportive ose turistike;

18. "Peshkim bregdetar" është peshkimi i kryer me anë të mjeteve lundruese që kthehen çdo ditë ose brenda 36 orësh në një port që ndodhet në territorin e një shteti anëtar, pa ndaluar në një port që ndodhet në një vend të tretë;

19. "Kërcënim për shëndetin publik" është çdo sëmundje që ka potencial epidemik, siç përcaktohet nga Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe çdo sëmundje infektive ose sëmundje parazitare ngjithëse, nëse i nënshtrohen dispozitave mbrojtëse që zbatohen për shtetasit e shteteve anëtare.

Neni 3

### **Objekti**

Kjo rregullore zbatohet për çdo person që kalon kufijtë e brendshëm ose të jashtëm të shteteve anëtare, pa cenuar:

a) të drejtat e personave që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë:

b) të drejtat e refugjatëve dhe personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare, në veçanti në lidhje me moskthimin.

TITULLI II

## KUFIJTË E JASHTËM

### KREU I

#### KALIMI I KUFIJVE TË JASHTËM DHE KUSHTET E HYRJES

##### Neni 4

#### **Kalimi i kufijve të jashtëm**

1. Kufijtë e jashtëm mund të kalohen vetëm në pikat e kalimit kufitar dhe gjatë orarit të caktuar të hapjes. Orari i hapjes tregohet qartësisht në pikat e kalimit kufitar që nuk janë të hapura 24 orë në ditë.

Shtetet anëtare i njoftojnë Komisionit, në përputhje me nenin 34, listën e pikave të kalimit kufitar.

2. Duke deroguar nga paragrafi 1, përjashtimet nga detyrimi për të kaluar kufijtë e jashtëm vetëm në pikat e kalimit kufitar gjatë orarit të caktuar të hapjes mund të lejohen:

- a) në lidhje me lundrimin argëtues ose peshkimin bregdetar;
- b) për marinarët që dalin në breg për të qëndruar në zonën e portit ku ndalojnë anijet e tyre ose në bashkitë pranë tyre;
- c) për individë ose grupe personash, kur ekziston kërkesa e një natyre të veçantë, me kusht që të ata të zotërojnë lejet e kërkuara nga legjislacioni i brendshëm dhe të mos ketë konflikt me interesat e politikave publike dhe sigurisë së brendshme të shteteve anëtare;
- d) për individë ose grupe personash, në rastin e një situatë emergjente të paparashikuar.

3. Pa cenuar përjashtimet e parashikuara në paragrafin 2 ose detyrimet e tyre për mbrojtje ndërkombëtare, shtetet anëtare prezantojnë penalitete, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm, për kalimin e paautorizuar të kufijve të jashtëm në vende të ndryshme nga pikat e kalimit kufitar ose në orare të ndryshme nga orari i caktuar i hapjes. Këto penalitete duhet të jenë efektive, proporcionale dhe shtrënguese.

##### Neni 5

#### **Kushtet e hyrjes për shtetasit e vendeve të treta**

1. Për qëndrime jo më shumë se tre muaj gjatë një periudhe gjashtë mujore, kushtet e hyrjes për shtetasit e vendeve të treta janë si në vijim:

- a) të jenë të pajisur me dokument të vlefshëm udhëtimi ose një dokument që i autorizon të kalojnë kufirin;
- b) të jenë të pajisur me vizë të vlefshme, nëse kërkohet në zbatim të Rregullores së Këshillit (KE) nr. 539/2001, datë 15 mars 2001, "Për listimin e vendeve të treta shtetasit e të



cilëve duhet të jenë të pajisur me vizë kur kalojnë kufijtë e jashtëm dhe vendet e treta shtetasit e të cilëve përjashtohen nga kjo kërkesë"<sup>17</sup>, përveç rasteve kur janë të pajisur me leje qëndrimi;

c) të justifikojnë qëllimin dhe kushtet e qëndrimit të synuar dhe të kenë burime të mjaftueshme si për kohëzgjatjes e qëndrimit të synuar ashtu edhe për kthimin drejt vendit të tyre të origjinës ose transitit përmes një vendi të tretë ku janë të sigurt se do të pranohen, ose të jenë në gjendje t'i përfitojnë këto mjete në mënyrë të ligjshme;

d) të mos jenë persona për të cilët është nxjerrë një njoftim në SIS me qëllim refuzimin e hyrjes;

e) të mos konsiderohen si rrezik për politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik apo marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjë prej shteteve anëtare, në veçanti kur nuk është lëshuar asnjë njoftim në bazat kombëtare të të dhënave të shteteve anëtare me qëllim refuzimin e hyrjes bazuar në të njëjtat arsye.

2. Shtojca I përfshin një listë të hapur të dokumenteve mbështetëse që roja kufitare mund t'i kërkojë një shtetasi të vendit të tretë për të verifikuar se janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, germa "c".

3. Mjetet e jetesës vlerësohen në përputhje me kohëzgjatjen dhe qëllimin e qëndrimit dhe duke iu referuar çmimeve mesatare në shtetet anëtare përkatëse për ushqim dhe akomodim jo të kushtueshëm, shumëzuar me numrin e ditëve të qëndrimit.

Shumat referencë të përcaktuara nga shtetet anëtare i njoftohen Komisionit në përputhje me nenin 34.

Vlerësimi i mjeteve të mjaftueshme të jetesës mund të bazohet në paratë cash, çeqet e udhëtarit ose kartat e kreditit që ka në zotërim shtetasi i vendit të tretë. Deklaratat e sponsorizimit, kur këto deklarata parashikohen nga legjislacioni i brendshëm, dhe letrat e garancisë nga mikpritësit, siç përcaktohen nga legjislacioni i brendshëm, në rastet kur shtetasi i një vendi të tretë qëndron te një mikpritës, gjithashtu mund të shërbejnë si provë e mjeteve të mjaftueshme të jetesës.

4. Duke deroguar nga paragrafi 1:

a) shtetasit e vendeve të treta që nuk përmbushin të gjitha kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, por zotërojnë një leje qëndrimi ose vizë për rihyrje të lëshuar nga një prej shteteve anëtare, ose, kur kërkohet, të dy dokumentet, autorizohet të hyjnë në territoret e shteteve të tjera anëtare për qëllime transiti me qëllim që të arrijnë në territorin e shtetit anëtar që ka lëshuar lejen e qëndrimit ose vizës për rihyrje, përveç se kur emrat e tyre janë në listën kombëtare të njoftimeve të shtetit anëtar kufij të jashtëm të të cilit ata po përpiqen të kalojnë dhe njoftimi shoqërohet me udhëzime për të refuzuar hyrjen ose transitin;

b) shtetasit e vendeve të treta që përmbushin kushtet e përcaktuara në paragrafin 1, përveç atyre që përcaktohen në germën "b", dhe të cilët paraqiten përpara kufirit mund të autorizohen të hyjnë në territoret e shteteve anëtare nëse lëshohet një vizë në kufi në përputhje

me Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 415/2003, datë 27 shkurt 2003, "Për nxjerrjen e vizave në kufi, duke përfshirë nxjerrjen e vizave për marinarët në transit"<sup>18</sup>.

Vizat që lëshohen në kufi regjistrohen në një listë.

Nëse është e pamundur që viza të ngjitet në dokument, në raste të veçanta, ajo ngjitet në një fletë të ndarë e cila futet në dokument. Në këtë rast, përdoret formati uniform i formularëve për ngjitjen e vizës, i përcaktuar në Rregulloren e Këshillit (KE) nr. 333/2002, datë 18 shkurt 2002, "Për një format uniform të formularëve për ngjitjen e vizës së lëshuar nga shtetet anëtare për personat që zotërojnë dokumente udhëtimi që nuk njihen nga shteti anëtar që harton formularin"<sup>19</sup>;

c) shtetasit e vendeve të treta që nuk përmbushin njërin ose më shumë prej kushteve të përcaktuar në paragrafin 1 mund të autorizohen nga një shtet anëtar që të hyjnë në territorin e tij për arsye humanitare, për arsye të interesit kombëtar ose për shkak të detyrimeve ndërkombëtare. Kur shtetasi një vendi të tretë është subjekt i një njoftimi, siç përmendet në paragrafin 1, germa "d", shteti anëtar që e autorizon atë të hyjë në territorin e tij informon shtetet e tjera anëtare për sa më lart.

## KREU II

### KONTROLLI I KUFIJVE TË JASHTËM DHE REFUZIMI I HYRJES

#### Neni 6

#### **Kryerja e verifikimeve kufitare**

1. Rojat kufitare, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, respektojnë plotësisht dinjitetin njerëzor.

Çdo masë e marrë në përmbushje të detyrave të tyre është proporcionale me objektivat e synuara nga këto masa.

2. Gjatë kryerjes së verifikimeve kufitare, rojat kufitare nuk diskriminojnë personat për shkak të gjinisë, racës, origjinës etnike, fesë ose besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual.

#### Neni 7

#### **Verifikimet e personave në kufi**

1. Lëvizja ndërkufitare në kufijtë e jashtëm i nënshtrohet verifikimeve nga rojat kufitare. Verifikimet kryhen në përputhje me këtë kre.

Verifikimet mund të mbulojnë edhe mjetet e transportit dhe objektet në zotërim të personave që kalojnë kufirin. Për çdo kontroll që kryhet zbatohet ligji i shtetit anëtar përkatës.

2. Të gjithë personat i nënshtrohen një verifikimi minimal për të përcaktuar identitetin e tyre, përmes paraqitjes prej tyre të dokumenteve të udhëtimit. Ky verifikim minimal konsiston në një verifikim të shpejtë dhe të menjëhershëm të vlefshmërisë së dokumentit që autorizon mbajtësin legjitim të kalojë kufirin dhe të pranisë së shenjave të falsifikimit, duke përdorur, sipas rastit, pajisje teknike dhe duke u konsultuar, në bazat përkatëse të të dhënave, me informacionet që lidhen ekskluzivisht me dokumentet e vjedhura, të përvetësuara, të humbura dhe të zhvlerësuara.

Verifikimi minimal që përmendet në nënparagrafin e parë është rregulli që zbatohet për personat që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë.

Megjithatë, në mënyrë josistematike, gjatë kryerjes së verifikimeve minimale të personave që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë, rojat kufitare mund të konsultohen me bazat kombëtare dhe evropiane të të dhënave për t'u siguruar që këto persona nuk përfaqësojnë një kërcënim të pastër, aktual dhe mjaftueshëm serioz për sigurinë e brendshme, politikat publike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare të shteteve anëtare, ose një kërcënim për shëndetin publik.

Pasojat e këtyre konsultimeve nuk vënë në rrezik të drejtën e hyrjes së personave që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë në territorin e shtetit anëtar përkatës, siç përcaktohet në Direktivën 2004/38/KE.

3. Gjatë hyrjes dhe daljes, shtetasit e vendeve të treta i nënshtrohen verifikimeve të imtësishme.

a) Verifikimet e imtësishme në hyrje përfshijnë verifikimin e kushteve që rregullojnë hyrjen, të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1 dhe, sipas rastit, të dokumenteve që autorizojnë banimin dhe kryerjen e një veprimtarie profesionale. Këtu përfshihet një shqyrtim i detajuar që mbulon aspektet e mëposhtme:

I. verifikimin se shtetasi i vendit të tretë është i pajisur me një dokument të vlefshëm për kalimin e kufirit, që nuk ka skaduar, dhe se dokumenti shoqërohet, sipas rastit, me vizën ose lejen e qëndrimit që kërkohet;

II. këqyrje e imtësishme e dokumentit të udhëtimit për shenja falsifikimi;

III. shqyrtimin e vulave hyrëse dhe dalëse në dokumentin e udhëtimit të këtij shtetasi të vendit të tretë, me qëllim që të verifikohet, duke krahasuar të dhënat e hyrjes dhe daljes, se personi nuk e ka tejkaluar kohëzgjatjen maksimale të qëndrimit të autorizuar në territorin e shteteve anëtare;

IV. verifikimin e pikës së nisjes dhe pikës së mbërritjes së shtetasit të një vendi të tretë dhe qëllimi i qëndrimit të synuar, duke verifikuar, nëse është e nevojshme, dokumentet mbështetëse përkatëse;

V. verifikimin që ky shtetas i vendit të tretë ka mjete të mjaftueshme jetese për kohëzgjatjen dhe qëllimin e qëndrimit, për kthimin në vendin e origjinës ose transitin në një vend

të tretë ku ai ose ajo është e sigurt se do të pranohet, ose që ai ose ajo është në gjendje të përfitojë këto mjete në mënyrë të ligjshme;

VI. verifikimin se shtetasi i një vendi të tretë, mjetet e tij të transportit dhe objektet që ai transporton nuk kanë gjasa të vënë në rrezik politikën publike, sigurinë e brendshme, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjë prej shteteve anëtare. Ky verifikim përfshin konsultimin e drejtpërdrejtë me të dhënat dhe njoftimet për personat dhe, sipas rastit, objektet e përfshira në SIS dhe në skedarët kombëtarë të të dhënave dhe veprimet që duhet të kryhen, nëse ka, si rezultat i një njoftimi;

b) verifikimet e imtësishme në dalje përfshijnë:

I. verifikimin se shtetasi i vendit të tretë është i pajisur me një dokument të vlefshëm për kalimin e kufirit;

II. Verifikimin e dokumentit të udhëtimit për shenja falsifikimi ose imitimi të jashtëligjshëm;

III. sa herë që është e mundur, verifikimin që shtetasi i vendit të tretë nuk konsiderohet se përbën kërcënim për politikën publike, sigurinë e brendshme ose marrëdhëniet ndërkombëtare të ndonjërit prej shteteve anëtare;

c) Përveç verifikimeve të përmendura në germën "b", verifikimet e imtësishme në dalje gjithashtu mund të përfshijnë:

I. verifikimin se ky person është i pajisur me vizë të vlefshme, nëse kërkohet, sipas Rregullores (KE) nr. 539/2001, me përjashtim të rastit kur ai ose ajo është pajisur me një leje qëndrimi të vlefshme;

II. verifikimin se personi nuk ka shkelur afatin maksimal të qëndrimit në territorin e shteteve anëtare;

III. konsultimin me njoftimet për personat dhe sendet e përfshira në SIS dhe raportet në skedarët kombëtarë të të dhënave.

4. Kur ekzistojnë mjediset dhe nëse diçka e tillë kërkohet nga shtetasi i një vendi të tretë, këto verifikime të imtësishme kryen në një zonë private.

5. Shtetasit e një vendi të tretë që i nënshtrohen një verifikimi të imtësishëm të vijës së dytë informohen për qëllimin e këtij verifikimi dhe procedurat që përdoren.

Ky informacion është i disponueshëm në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së dhe në gjuhët e vendit ose vendeve që janë në kufi me shtetin anëtar në fjalë dhe tregon se shtetasi i një vendi të tretë mund të kërkojë emrin ose numrin e identifikimit të shërbimit të rojave kufitare që kryejnë verifikimin e imtësishëm të vijës së dytë, emrin e pikës së kalimit kufitar dhe datën në të cilën është kaluar kufiri.

6. Verifikimet për personat që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë kryhen në përputhje me Direktivën 2004/38/KE.

7. Rregullat e detajuara që rregullojnë informacionin që duhet të regjistrohet përcaktohen në shtojcën II.

## Neni 8

### **Lehtësimi i verifikimeve kufitare**

1. Verifikimet kufitare në kufijtë e jashtëm mund të lehtësohen si rezultat i rrethanave të veçanta dhe të paparashikuara. Situata të veçanta dhe të paparashikuara janë ato që sjellin ngarkesë në qarkullim në pikën e kalimit kufitar, duke shkaktuar pritje të gjata, dhe kur të gjitha burimet që lidhen me personelin, pajisjet, ambientet dhe organizimi janë shteruar.

2. Kur verifikimet kufitare lehtësohen në përputhje me paragrafin 1, verifikimet kufitare të lëvizjeve në hyrje në parim kanë përparësi ndaj verifikimeve të lëvizjeve në dalje.

Vendimi për të lehtësuar verifikimet merret nga roja kufitare që ka komandën në pikën e kalimit kufitar.

Ky lehtësim i verifikimeve është i përkohshëm, i përshtatur sipas rrethanave që e justifikojnë atë dhe zbatohet gradualisht.

3. Edhe në rastet ku verifikimet janë të lehtësuara, roja kufitare vulos dokumentet e udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta në hyrje dhe në dalje, në përputhje me nenin 10.

4. Çdo shtet anëtar i transmeton një herë në vit Parlamentit Evropian dhe Komisionit një raport për zbatimin e këtij neni.

## Neni 9

### **Korsitë e veçanta dhe informacioni që jepet në tabela**

1. Shtetet anëtare ofrojnë korsi të veçanta, sidomos në pikat e kalimit të kufirit ajror, për të kryer verifikime të personave, në përputhje me nenin 7. Këto korsi ndahen nëpërmjet tabelave që tregojnë informacionet e përcaktuara në shtojcën III.

Shtetet anëtare mund të ofrojnë korsi të ndara në pikat e kalimit kufitar në det dhe tokë dhe në kufijtë ndërmjet shteteve anëtare që nuk zbatojnë nenin 20 në kufijtë e tyre të përbashkët. Tabelat që përmbajnë informacionet e përcaktuara në shtojcën III, do të përdoren nëse shtetet anëtare ofrojnë korsi të ndara në këto kufij.

Shtetet anëtare garantojnë që këto korsi të shënjojnë qartësisht, duke përfshirë rastet kur rregullat që lidhen me përdorimin e korsive të ndryshme anashkalohen, siç parashikohet në paragrafin 4, për të garantuar nivelet e qarkullimit optimal të personave që kalojnë kufirin.

2. a) Personat që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë kanë të drejtën të përdorin korsitë që mbajnë tabelën e treguar në pjesën A të shtojcës III. Ata gjithashtu mund të përdorin korsitë që mbajnë tabelën e treguar në pjesën B të shtojcës III.

b) Të gjithë personat e tjerë përdorin korsitë që mbajnë tabelën e treguar në pjesën B të shtojcës III.

Informacionet në tabelën e përmendur në germa "a" dhe "b" mund të shfaqen në gjuhët që konsiderohen si të përshtatshme nga secili shtet anëtar.

3. Në pikat e kalimit të kufirit detar dhe tokësor, shtetet anëtare mund të ndajnë trafikun e automjeteve në dy korsi të ndryshme për automjete të lehta dhe automjete të rënda dhe autobusë duke përdorur tabelat e treguara në pjesën C të shtojcës III.

Shtetet anëtare mund të ndryshojnë informacionet në këto tabela, sipas rastit, duke iu përshtatur rrethanave lokale.

4. Në rastin e çekuilibrit të përkohshëm të qarkullimit në një pikë të caktuar të kalimit kufitar, autoritetet kompetente mund të shmangin zbatimin e rregullave për përdorimin e korsive të ndryshme për aq kohë sa është e nevojshme për të eliminuar këtë çekuilibrim.

5. Përshtatja e tabelave ekzistuese sipas dispozitave të paragrafit 1, 2 dhe 3 përfundon përpara 31 majit 2009. Kur shtetet anëtare zëvendësojnë tabelat ekzistuese ose vendosin tabela të reja përpara kësaj date, ata veprojnë në pajtim me udhëzimet e parashikuara në këto paragrafë.

Neni 10

### **Vulosja e dokumenteve të udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta**

1. Dokumentet e udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta vulosen rregullisht në hyrje dhe në dalje të kufirit shtetëror. Specifikisht, vula e hyrjes ose e daljes vendoset në:

a) dokumentet me vizë të vlefshme, që lejojnë shtetasit e vendeve të treta të kalojnë kufirin;

b) dokumentet që lejojnë shtetasit e vendeve të treta të kalojnë kufirin shtetëror, pasi u është lëshuar një vizë në kufi;

c) dokumentet që lejojnë të kalojnë kufirin shtetëror shtetasit e vendeve të treta që nuk kanë nevojë për vizë.

2. Dokumentet e udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta që janë anëtarë të familjes së një qytetari të BE-së, për të cilët zbatohet Direktiva 2004/38/KE, por që nuk paraqesin kartën e qëndrimit që parashikohet në nenin 10 të asaj direktive, vulosen në hyrje ose dalje.

Dokumentet e udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta që janë anëtarë të familjes së shtetasve të vendeve të treta që gëzojnë të drejtën komunitare të lëvizjes së lirë, por që nuk

paraqesin kartën e qëndrimit që parashikohet në nenin 10 të Direktivës 2004/38/KE, vulosen në hyrje ose dalje.

3. Nuk vendoset vulë në hyrje ose në dalje në:

a) dokumentet e udhëtimit të krerëve të shteteve dhe personaliteteve, mbërritja e të cilëve është njoftuar paraprakisht në rrugë zyrtare, nëpërmjet kanaleve diplomatike;

b) licencat e pilotëve ose certifikatat e anëtarëve të ekuipazhit të avionëve;

c) dokumentet e udhëtimit të marinarëve që janë të pranishëm në territorin e një shteti anëtar vetëm kur anija e tyre ndalon dhe në zonën e portit të ndalimit;

d) dokumentet e udhëtimit të ekuipazhit dhe udhëtarëve të anijeve turistike që nuk i nënshtrohen verifikimeve kufitare në përputhje me pikën 3.2.3 të shtojcës VI;

e) dokumentet që i lejojnë shtetasve të Andorës, Monakos dhe San Marinos të kalojnë kufirin;

Në raste të veçanta, me kërkesë të një shtetasi të një vendi të tretë, vula në hyrje ose në dalje mund të mos vendoset, nëse vendosja e saj mund të shkaktojë vështirësi të rënda për atë person. Në këtë rast, hyrja ose dalja regjistrohet në një fletë të veçantë ku tregohet emri dhe numri i pasaportës. Kjo fletë i jepet shtetasit të vendit të tretë.

4. Masat praktike për vulosjen përcaktohen në shtojcën IV.

5. Kur është e mundur, shtetasit e vendeve të treta informohen për detyrimin e rojave kufitare për të vulosur dokumentet e tyre të udhëtimit në hyrje dhe në dalje, edhe kur verifikimet janë të lehtësuara, në përputhje me nenin 8.

6. Komisioni i raporton Parlamentit Evropian dhe Këshillit në fund të vitit 2008 për funksionimin e dispozitave për vulosjen e dokumenteve të udhëtimit.

## Neni 11

### **Prezumimi në lidhje me përmbushjen e kushteve të kohëzgjatjes së qëndrimit**

1. Nëse dokumenti i udhëtimit të një shtetasi të vendit të tretë nuk ka vulë hyrjeje, autoritetet kompetente kombëtare mund të prezumojnë se mbajtësi nuk ka përmbushur, ose nuk përmbush më, kushtet për kohëzgjatjen e qëndrimit, të zbatueshme brenda shtetit anëtar përkatës.

2. Prezumimi i përmendur në paragrafin 1 mund të hidhet poshtë kur shtetasi i vendit të tretë ofron, në çfarëdo mënyre, prova të besueshme, të tilla si bileta transporti, ose prova për praninë e tij ose të saj jashtë territorit të shteteve anëtare, që tregojnë se ai ose ajo ka respektuar kushtet që lidhen me kohëzgjatjen e një qëndrimi të shkurtër.

Në këtë rast:

a) kur shtetasi i vendit të tretë gjendet në territorin e një shteti anëtar që zbaton plotësisht tërësinë e legjislacionit të Shengenit, autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën e brendshme, tregojnë në dokumentin e tij të udhëtimit datën dhe vendin ku ai ka kaluar kufirin e jashtëm të një prej shteteve anëtare që zbaton plotësisht tërësinë e legjislacionit të Shengenit;

b) kur shtetasi i një vendi të tretë gjendet në territorin e një shteti anëtar në lidhje me të cilin vendimi i shqyrtuar në nenin 3, paragrafi 2 të Aktit të Anëtarësimit të vitit 2003 nuk është marrë, autoritetet kompetente tregojnë, në përputhje me legjislacionin dhe praktikën e brendshme, në dokumentin e tij të udhëtimit datën kur dhe vendin ku ai ka kaluar kufirin e jashtëm të këtij shteti anëtar.

Përveç vendosjes së datave, siç përmendet në germën "a" dhe "b", shtetasit të një vendi të tretë mund t'i jepet një formular, siç tregohet në shtojcën III.

Shtetet anëtare informojnë njëri tjetrin dhe Komisionin dhe Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit për praktikën e tyre të brendshme në lidhje me informacionet e përmendura në këtë nen.

3. Nëse prezumimi i përmendur në nenin 1 nuk anulohet, autoritetet kompetente mund ta dëbojnë shtetasin e vendit të tretë nga territori i shteteve anëtare përkatëse.

## Neni 12

### **Mbikëqyrja e kufirit**

1. Qëllimi kryesor i mbikëqyrjes së kufirit është parandalimi i kalimeve të paautorizuara të kufirit, lufta kundër kriminalitetit ndër-kufitar dhe marrja e masave kundër personave që kanë kaluar kufirin në mënyrë të paligjshme.

2. Rojat kufitare përdorin njësi të përhershme ose të lëvizshme për të kryer mbikëqyrjen e kufirit.

Mbikëqyrja kryhet në mënyrë të tillë që të parandalojë dhe të mos u lejojë personave që të shmangin verifikimet në pikat e kalimit kufitar.

3. Mbikëqyrja ndërmjet pikave të kalimit kufitar kryhet nga rojat kufitare, numri dhe metodat e të cilëve janë të përshtatura sipas rreziqeve dhe kërcënimeve ekzistuese apo atyre të parashikuara. Mbikëqyrja përfshin ndryshime të shpeshta dhe të papritura të periudhave të saj, në mënyrë të tillë që kalimet e paautorizuara të kufirit të jenë përherë në rrezik për t'u zbuluar.

4. Mbikëqyrja kryhet me njësi stacionare ose të lëvizshme, të cilat kryejnë detyrën e tyre duke patrulluar ose duke u pozicionuar në vende të njohura apo të vlerësuara si me risk të lartë, duke pasur si qëllim zbulimin dhe kapjen e personave, që kalojnë kufirin në mënyrë të jashtëligjshme. Mbikëqyrja mund të kryhet edhe me mjete teknike, duke përfshirë ato elektronike.



5. Rregullat shtesë që rregullojnë mbikëqyrjen mund të miratohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 33, paragrafi 2.

## Neni 13

### **Refuzimi i hyrjes**

1. Një shtetasi i një vendi të tretë që nuk përmbush kushtet e hyrjes që përcaktohen në nenin 5, paragrafi 1 dhe nuk i përket kategorive të personave të përmendur në nenin 5, paragrafi 4, i refuzohet hyrja në territoret e shteteve anëtare. Kjo nuk cenon zbatimin e dispozitave të veçanta në lidhje me të drejtën e azilit dhe të mbrojtjes ndërkombëtare ose me lëshimin e vizave afatgjata.

2. Hyrja mund të refuzohet vetëm me anë të një vendimi të arsyetuar ku paraqiten arsye specifike të refuzimit. Vendimi merret nga autoriteti i autorizuar nga legjislacioni i brendshëm. Ai hyn në fuqi menjëherë.

Vendimi i arsyetuar ku paraqiten arsye specifike të refuzimit jepet në formën e një formulari standard, siç përcaktohet në shtojcën V, pjesa B, i plotësuar nga autoriteti i autorizuar nga legjislacioni i brendshëm për të refuzuar hyrjen. Formulari standard i plotësuar i dorëzohet shtetasit të vendit të tretë në fjalë, i cili konfirmon marrjen e vendimit të refuzimit të hyrjes nëpërmjet atij formulari.

3. Personat të cilëve u refuzohet hyrja kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e refuzimit. Ankimimet trajtohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm. Shtetasi i një vendi të tretë pajiset gjithashtu me një listë të shkruar të pikave të kontaktit që mund të japin informacione mbi përfaqësuesit kompetentë për të vepruar në emër të shtetasit të një vendi të tretë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

Depozitimi i ankimit nuk ka efekt pezullues të vendimit të refuzimit të hyrjes.

Pa cenuar asnjë kompensim që jepet në përputhje me legjislacionin e brendshëm, kur trupi gjykues i ankimit del në përfundimin se vendimi për të refuzuar hyrjen nuk ka qenë i mbështetur në arsye të mirëqena, shtetasi i vendit të tretë ka të drejtë të kërkojë nga shteti anëtar që i ka refuzuar hyrjen korrigjimin e vulës së hyrjes dhe çdo fshirje ose shtesë që i është bërë.

4. Rojat kufitare sigurohen që shtetasi i një vendi të tretë, të cilit i është refuzuar hyrja, të mos hyjë në territorin e shtetit anëtar në fjalë.

5. Shtetet anëtare mbledhin statistika për numrin e personave që u është refuzuar hyrja, arsye të refuzimit, kombësinë e personave të refuzuar dhe llojin e kufirit (tokësor, ajror ose detar) ku u është refuzuar hyrja. Shtetet anëtare ia transmetojnë këto statistika një herë në vit Komisionit. Çdo dy vjet, Komisioni publikon një përmbledhje të statistikave të dhëna nga shtetet anëtare.

6. Rregullat e detajuara që rregullojnë refuzimin e hyrjes janë paraqitur në pjesën A të shtojcës V.

## KREU III

### STAFI DHE BURIMET PËR KONTROLLIN KUFITAR DHE BASHKËPUNIMI NDËRMJET SHTETEVE ANËTARE

#### Neni 14

##### **Stafi dhe burimet për kontrollin kufitar**

Shtetet anëtare përdorin staf dhe burime të përshtatshme në një sasi të mjaftueshme për të kryer kontrollin kufitar në kufijtë e jashtëm, në përputhje me nenet 6 dhe 13, në një mënyrë të tillë që garanton një nivel efikas, të lartë dhe uniform kontrolli në kufijtë e jashtëm.

#### Neni 15

##### **Zbatimi i kontroleve**

1. Kontrolli kufitar i parashikuar në nenet 6 deri në 13 kryhet nga rojat kufitare në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe me legjislacionin e brendshëm.

Gjatë kryerjes së kontrollit kufitar, kompetencat për të nisur procedurat penale, të cilat i jepen rojave kufitare nga legjislacioni i brendshëm dhe që shkojnë përtej objektivit të kësaj rregulloreje, mbeten të paprekura.

Shtetet anëtare sigurohen që rojat kufitare të jenë profesionistë të specializuar dhe të trajnuar siç duhet. Shtetet anëtare i nxisin rojat kufitare që të mësojnë gjuhë, në veçanti ato që janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre.

2. Shtetet anëtare i njoftojnë Komisionit listën e shërbimeve kombëtare përgjegjëse për kontrollin kufitar në zbatim të legjislacionit të tyre të brendshëm, në përputhje me nenin 34.

3. Për të kontrolluar kufijtë me efikasitet, çdo shtet anëtar siguron bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm ndërmjet shërbimeve kombëtare përgjegjëse për kontrollin kufitar.

#### Neni 16

##### **Bashkëpunimi mes shteteve anëtare**

1. Shtetet anëtare mbështesin njëri tjetrin dhe ruajnë një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm për të pasur një zbatim efikas të kontrollit kufitar, në përputhje me nenet 6 deri në 15. Ata shkëmbejnë të gjitha informacionet përkatëse.

2. Bashkëpunimi operacional ndërmjet shteteve anëtare në fushën e menaxhimit të kufijve të jashtëm koordinohet nga Agjencia Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare (në vijim "Agjencia"), e themeluar nëpërmjet Rregullores (KE) nr. 2007/2004.

3. Pa cenuar kompetencat e Agjencisë, shtetet anëtare mund të vazhdojnë bashkëpunimin operacional me shtetet e tjera anëtare dhe/ose vendet e treta në kufijtë e jashtëm, duke përfshirë shkëmbimin e oficerëve të ndërlidhjes, kur ky bashkëpunim plotëson veprimet e Agjencisë.

Shtetet anëtare nuk bëhen pjesë e asnjë veprimtarie që mund të rrezikojë funksionimin e Agjencisë ose arritjen e objektivave të saj.

Shtetet anëtare i raportojnë Agjencisë për bashkëpunimin operacional të përmendur në nënparagrafin e parë.

4. Shtetet anëtare ofrojnë trajnim për rregullat e kontrollit kufitar dhe për të drejtat themelore. Në këtë drejtim, merren në konsideratë standardet e përbashkëta të trajnimit të përcaktuara dhe të zhvilluara më tej nga Agjencia.

Neni 17

### **Kontrolli i përbashkët**

1. Shtetet anëtare që nuk zbatojnë nenin 20 në kufijtë e përbashkët tokësor, deri në datën e zbatimit të këtij neni, mund të kryejnë kontrole të përbashkëta të këtyre kufijve, dhe në këtë rast një person mund të ndalohe vetëm një herë për të kryer verifikimet e hyrjes dhe daljes, pa cenuar përgjegjësitë individuale të shteteve anëtare që lind nga nenet 6 deri në 13.

Për këtë qëllim, shtetet anëtare mund të lidhin marrëveshje dypalëshe ndërmjet tyre.

2. Shtetet anëtare informojnë Komisionin për çdo marrëveshje të lidhur në përputhje me paragrafin 1.

KREU IV

### **RREGULLAT SPECIFIKE PËR VERIFIKIMET NË KUFIT**

Neni 18

#### **Rregullat specifike për lloje të ndryshme kufijsh dhe mjete të ndryshme transporti që përdoren për të kaluar kufijtë e jashtëm**

Rregullat specifike që përcaktohen në shtojcën VI zbatohen për verifikimet që kryhen në lloje të ndryshme kufijsh dhe për mjete të ndryshme transporti që përdoren për të kaluar pikat e kalimit kufitar.

Këto rregulla specifike mund të përmbajnë shmangie nga neni 5 dhe nenet 7 deri në 13.

Neni 19

#### **Rregullat specifike për verifikimet e disa kategorive të personave**

1. Rregullat specifike të përcaktuara në shtojcën VII zbatohen për verifikimet e personave të kategorive të mëposhtme:

- a) krerët e shteteve dhe anëtarët e delegacioneve të tyre;
- b) pilotët e mjeteve të fluturimit dhe anëtarë të tjerë të ekuipazhit;
- c) marinarët;
- d) mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit dhe anëtarët e organizatave ndërkombëtare;
- e) punëtorët ndërkufitarë;
- f) të miturit.

Këto rregulla specifike mund të përmbajnë shmangie nga neni 5 dhe nenet 7 deri në 13.

2. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për kartat model që lëshohen nga ministritë e tyre të jashtme për anëtarët e akredituar të misioneve diplomatike dhe përfaqësive konsullore dhe anëtarët e familjeve të tyre, në përputhje me nenin 34.

### TITULLI III

#### KUFIJTË E BRENDSHËM

##### KREU I

#### SHFUQIZIMI I KONTROLLIT KUFITAR NË KUFIJTË E BRENDSHËM

##### Neni 20

#### **Kalimi i kufijve të brendshëm**

Kufijtë e brendshëm mund të kalohen në çdo pikë pa kryer asnjë verifikim kufitar të personave, pavarësisht kombësisë së tyre.

##### Neni 21

#### **Verifikimet brenda territorit**

Shfuqizimi i kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm nuk prek:

a) ushtrimin e kompetencave policore nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare në zbatim të legjislacionit të brendshëm, për sa kohë që ushtrimi i këtyre kompetencave nuk ka një efekt të barasvlershëm me verifikimet kufitare; kjo gjen zbatim edhe në zonat kufitare. Sipas kuptimit të fjalisë së parë, ushtrimi i kompetencave policore, veçanërisht, nuk mund të konsiderohet i barasvlershëm me ushtrimin e verifikimeve kufitare kur masat policore:

I. nuk kanë si objektiv kontrollin kufitar,

II. bazohen në informacionet dhe përvojën e përgjithshme policore lidhur me kërcënimet e mundshme ndaj sigurisë publike dhe, synojnë veçanërisht të luftojnë krimin ndërkufitar;

III. janë krijuar dhe ekzekutohen në një mënyrë qartësisht të ndryshme nga verifikimet e rregullta të personave në kufijtë e jashtëm,

IV. kryhen mbi bazën e kontrolleve të befta;

b) verifikimet e sigurisë për personat, të cilat kryhen në porte dhe aeroporte nga autoritetet kompetente në zbatim të legjislacionit të secilit prej shteteve anëtare, nga zyrtarët e portit ose aeroportit, ose transportuesit, me kusht që këto verifikime të kryhen për personat që udhëtojnë brenda një shteti anëtar;

c) mundësinë që një shtet anëtar të parashikojë me ligj një detyrim për t'u pajisur ose për të mbajtur dokumente udhëtimi dhe dokumente të tjera identifikimi me vete;

d) detyrimin për shtetasit e vendeve të treta që të raportojnë praninë e tyre në territorin e çdo shteti anëtar, sipas dispozitave të nenit 22 të Konventës Shengen.

Neni 22

### **Heqja e pengesave të trafikut në pikat e kalimit kufitar rrugor në kufijtë e brendshëm**

Shtetet anëtare heqin të gjitha pengesat për qarkullimin e vazhdueshëm në pikat e kalimit rrugor në kufijtë e brendshëm, veçanërisht, çdo kufizim shpejtësie që nuk bazohet ekskluzivisht në rregullat e sigurisë rrugore.

Gjithashtu, shtetet anëtare përgatiten për të ofruar lehtësime të verifikimeve kufitare në rast të rivendosjes së kontrolleve në kufijtë e brendshëm.

KREU II

### **RIVENDOSJA E PËRKOHSHME E KONTROLLIT KUFITAR NË KUFIJTË E BRENDSHËM**

Neni 23

#### **Rivendosja e përkohshme e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm**

1. Kur ka kërcënime serioze për politikat publike ose sigurinë e brendshme, një shtet anëtar, në raste përjashtimore, mund të rivendosë kontrollin kufitar në kufijtë e tij të brendshëm për një periudhë të kufizuar prej jo më shumë se 30 ditësh ose përgjatë kohëzgjatjes së parashikueshme të kërcënimit serioz, nëse kohëzgjatja e tij tejkalon periudhën prej 30 ditësh, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 24, ose, në raste urgjente, me procedurën e përcaktuar në nenin 25. Qëllimi dhe kohëzgjatja e rikthimit të përkohshëm të kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm nuk tejkalon minimumin e domosdoshëm për t'iu përgjigjur kërcënimit serioz.

2. Nëse kërcënimi serioz për politikat e publike ose sigurinë e brendshme vazhdon përtej periudhës së parashikuar në paragrafin 1, shteti anëtar mund të zgjasë kontrollin kufitar për të njëjtat arsye me ato që përmenden në paragrafin 1 dhe duke marrë në konsideratë çdo element të ri, për periudha të rinovueshme deri në 30 ditë, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 26.

#### Neni 24

### **Procedura për ngjarjet e parashikueshme**

1. Kur një shtet anëtar planifikon të rikthejë kontrollin kufitarë në kufijtë e brendshëm sipas nenit 23, paragrafi 1, ai njofton, sa më shpejt që të jetë e mundur, shtetet e tjera dhe Komisionin për këtë fakt dhe jep informacionet e mëposhtme, sapo ato të jenë të disponueshme:

a) arsyet për rikthimin e propozuar, duke dhënë detaje të ngjarjeve që përbëjnë një kërcënim serioz për politikat publike ose sigurinë e brendshme;

b) qëllimin e rikthimit të propozuar, duke specifikuar vendin se ku do të rikthehet kontrolli kufitar;

c) emrat e pikave të autorizuara të kalimit;

d) datën dhe kohëzgjatjen e rikthimit të propozuar;

e) sipas rastit, masat që duhet të marrin shtetet e tjera anëtare.

2. Pas njoftimit nga shteti anëtar në fjalë, dhe duke marrë në konsideratë konsultimin e parashikuar në paragrafin 3, Komisioni mund të lëshojë një opinion pa cenuar nenin 64, paragrafi 1 të traktatit.

3. Informacioni i përmendur në paragrafin 1, si edhe mendimi që Komisioni mund të japë në përputhje me paragrafin 2, është subjekt i konsultimeve ndërmjet shtetit anëtar që planifikon të rikthejë kontrollin kufitar, shtetet anëtare të tjera dhe Komisionin, me qëllim që të organizohet, sipas rastit, bashkëpunimi i ndërsjellë ndërmjet shteteve anëtare dhe për të shqyrtuar proporcionalitetin e masave për ngjarjet që çojnë në rikthimin e kontrollit kufitar dhe kërcënimet për politikat publike dhe sigurinë e brendshme.

4. Konsultimi i përmendur në paragrafin 3 kryhet të paktën pesëmbëdhjetë ditë përpara datës së planifikuar për rikthimin e kontrollit kufitar.

#### Neni 25

### **Procedurat për rastet që kërkojnë veprim urgjent**

1. Kur konsiderimet e politikave publike ose sigurisë së brendshme në një shtet anëtar kërkojnë marrjen e veprimeve urgjente, shtetet anëtare në fjalë mund të rikthejnë, në raste përjashtimore dhe menjëherë, kontrollin kufitar në kufijtë e brendshëm.

2. Shteti anëtar që rikthen kontrollin kufitar në kufijtë e brendshëm njoftojnë, menjëherë, shtetet anëtare dhe Komisionin për këtë rikthim dhe jep informacionin që përmendet në nenin 24, paragrafi 1 dhe arsyet që justifikojnë përdorimin e kësaj procedure.

Neni 26

### **Procedura për zgjatjen e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm**

1. Shtetet anëtare mund ta zgjasin kontrollin kufitar në kufijtë e brendshëm vetëm në zbatim të nenit 23, paragrafi 2 pasi të kenë njoftuar shtetet e tjera anëtare dhe Komisionin.

2. Shteti anëtar që planifikon të zgjasë kontrollin kufitar i jep shteteve të tjera anëtare dhe Komisionit të gjithë informacionin në lidhje me arsyet për zgjatjen e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm. Zbatohen dispozitat e nenit 24, paragrafi 2.

Neni 27

### **Informimi i Parlamentit Evropian**

Shteti anëtar në fjalë, ose, sipas rastit, Këshilli informon, sa më shpejt që të jetë e mundur, Parlamentin Evropian për masat e marra në zbatim të neneve 24, 25 dhe 26. Për sa i përket zgjatjes së tretë të njëpasnjëshme sipas nenit 26, shteti anëtar në fjalë, nëse i kërkohet, i raporton Parlamentit Evropian për nevojën për kontrollin kufitar në kufijtë e brendshëm.

Neni 28

### **Dispozitat që duhet të zbatohen kur kontrolli kufitar rikthehet në kufijtë e brendshëm**

Kur rivendoset kontrolli kufitar në kufijtë e brendshëm, zbatohen rast pas rasti dispozitat e Titullit II.

Neni 29

### **Raporti për rivendosjen e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm**

Shteti anëtar që ka rikthyer kontrollin kufitar në kufijtë e brendshëm në zbatim të nenit 23 konfirmon datën në të cilën ky kontroll hiqet dhe, në të njëjtën kohë ose menjëherë në vijim, i paraqet një raport Parlamentit Evropian, Këshillit dhe Komisionit për rikthimin e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm, duke parashtruar, në veçanti, funksionimin e verifikimeve dhe efikasitetin e rikthimit të kontrollit kufitar.

Neni 30

### **Informimi i publikut**

Vendimi për rikthimin e kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm merret në mënyrë transparente dhe publiku informohet plotësisht për këtë rikthim, përveç se kur ekzistojnë arsye sigurie më të rëndësishme për të mos e bërë diçka të tillë.

Neni 31

### **Konfidencialiteti**

Me kërkesë të shtetit anëtar në fjalë, shtetet e tjera anëtare, Parlamenti Evropian dhe Komisioni respektojnë konfidencialitetin e informacionit të dhënë në lidhje me rikthimin dhe zgjatjen e kontrollit kufitar dhe të raportit të hartuar në zbatim të nenit 29.

## TITULLI IV

### DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 32

### **Ndryshimet e shtojcave**

Shtojcat III, IV dhe VIII ndryshohen në përputhje me procedurën e përmendur në nenin 33, paragrafi 2.

Neni 33

### **Komiteti**

1. Komisioni asistohet nga një komitet, në vijim "komiteti".

2. Në rastet kur referohet ky paragraf, zbatohen nenet 5 dhe 7 të Vendimit 1999/468/KE, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 8 të tij dhe me kusht që masat zbatuese që miratohen në përputhje me këtë procedurë të mos ndryshojnë dispozitat thelbësore të kësaj rregulloreje.

Periodha e përcaktuar në nenin 5, paragrafi 6 të Vendimit 1999/468/KE është tre muaj.

3. Komiteti miraton rregulloren e tij të brendshme.

4. Pa cenuar masat zbatuese të miratuara më parë, zbatimi i dispozitave të kësaj rregulloreje për zbatimin e rregullave teknike dhe vendimeve në përputhje me procedurën e përmendura në paragrafin 2 pezullohet katër vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Me propozim të Komisionit, Parlamenti Evropian dhe Këshilli mund të ripërtërijnë dispozitat në fjalë, sipas procedurës së parashikuar në nenin 251 të Traktatit dhe në këtë rast, ato procedojnë me këtë rishikim përpara përfundimit të periudhës katër vjeçare.

Neni 34

### **Njoftime**

1. Shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për:

a) listën e lejeve të qëndrimit;

b) listën e pikave të tyre të kalimit kufitar;



c) shumat referencë që kërkohen për kalimin e kufijve të tyre të jashtëm të përcaktuara në bazë vjetore nga autoritetet kombëtare;

d) listën e shërbimeve kombëtare përgjegjëse për kontrollin kufitar;

e) mostrën e modelit të kartave të lëshuara nga ministritë e jashtme.

2. Komisioni e vë informacionin e njoftuar në konformitet me paragrafin 1 në dispozicion të shteteve anëtare dhe publikut nëpërmjet botimit në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria C dhe nëpërmjet çdo mjeti tjetër të përshtatshëm.

Neni 35

### **Trafiku lokal kufitar**

Kjo rregullore nuk cenon rregullat e Komunitetit për trafikun lokal kufitar apo marrëveshjet dypalëshe ekzistuese për trafikun lokal kufitar

Neni 36

### **Seuta dhe Melija**

Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk prekin rregullat e veçanta që zbatohen për qytetet e Seutës dhe Melijës, siç përcaktohet në Deklaratën e Mbretërisë së Spanjës për qytetet e Seutës dhe Melijës në Aktin Final të Marrëveshjes për Anëtarësimin e Mbretërisë së Spanjës në Konventën që zbaton Marrëveshjen e Shengnit të 14 qershorit 1985 (20).

Neni 37

### **Njoftimi i informacionit nga shtetet anëtare**

Përpara 26 tetorit 2006, shtetet anëtare njoftojnë Komisionin për dispozitat e brendshme që lidhen me nenin 21, germa "c" dhe "d", penaltetet që përmenden në nenin 4, paragrafi 3 dhe marrëveshjet dypalëshe të lidhura në përputhje me nenin 17, paragrafi 1. Ndryshimet pasuese të këtyre dispozitave njoftohen brenda pesë ditëve pune.

Informacioni i njoftuar nga shtetet anëtare botohet në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian, seria C.

Neni 38

### **Raporti për zbatimin e titullit III**

Komisioni, përpara 13 tetorit 2009, i paraqet Parlamentit Evropian dhe Këshillit një raport për zbatimin e titullit III.

Komisioni i kushton vëmendje të veçantë çdo vështirësie që lind nga rikthimi i kontrollit kufitar në kufijtë e brendshëm. Sipas rastit, ai paraqet propozime që synojnë zgjidhjen e këtyre vështirësive.

## Neni 39

### **Shfuqizimet**

1. Nenet 2 deri në 8 të Konventës për zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit të 14 qershorit 1985 shfuqizohen duke nisur nga 13 tetori 2006.

2. Aktet e mëposhtme shfuqizohen duke nisur nga data e përmendur në paragrafin 1:

a) Manuali i përbashkët, duke përfshirë shtojcat e tij;

b) vendimet e Komitetit Ekzekutiv të Shengenit të 26 prillit 1994 (SCH/Com-ex (94) 1, rev 2), 22 dhjetorit 1994 (SCH/Com-ex (94)17, rev. 4) dhe 20 dhjetorit 1995 (SCH/Com-ex (95) 20, rev. 2);

c) shtojca 7 e Udhëzimeve të Përbashkëta Konsullore;

d) Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 790/2001, datë 24 prill 2001, që i jep Këshillit kompetenca zbatuese në lidhje me disa dispozita të detajuara dhe procedura praktike për kryerjen e verifikimeve dhe mbikëqyrjes kufitare<sup>21</sup>;

e) Vendimi i Këshillit 2004/581/KE, datë 29 prill 2004, që përcakton informacionet minimale që duhet të përdoren në tabelat në pikat e kalimit të kufirit të jashtëm<sup>22</sup>;

f) Vendimi i Këshillit 2004/574/KE, datë 29 prill 2004, "Për ndryshimin e Manualit të Përbashkët"<sup>23</sup>;

g) Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2133/2004, datë 13 dhjetor 2004, "Për kërkesën që autoritetet kompetente të shteteve anëtare të vulosin sistematikisht dokumentet e udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta, kur këta të fundit kalojnë kufijtë e jashtëm të shteteve anëtare dhe që ndryshon dispozitat e konventës që zbaton Marrëveshjen e Shengenit dhe manualin e përbashkët për këtë qëllim"<sup>24</sup>.

3. Referencat për nenet e fshira dhe instrumentet e shfuqizuara interpretohen si referenca për këtë rregullore.

## Neni 40

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi më 13 tetor 2006. Megjithatë, neni 34 hyn në fuqi ditën pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Kjo rregullore është detyruese në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha shtetet anëtare në përputhje me Traktatin themelues të Komunitetit Evropian.

Nënshkruar në Strasburg, më 15 mars 2006.

Për Parlamentin Evropian

Presidenti

J. BORRELL FONTELLES

Për Këshillin

Presidenti

H. WINKLER

---

## SHTOJCA I

### DOKUMENTET MBËSHTETËSE QË VERIFIKOJNË PËRMBUSHJEN E KUSHTEVE TË HYRJES

Dokumentet vërtetuese që përmenden në nenin 5, paragrafi 2 mund të përfshijnë sa më poshtë:

a) për udhëtimet e punës:

I. një ftesë nga një firmë ose një autoritet për të marrë pjesë në takime, konferenca ose evenimente që lidhen me tregtinë, industrinë ose punën;

II. dokumente të tjera që provojnë ekzistencën e marrëdhënieve tregtare ose të marrëdhënieve për qëllime pune;

III. biletat e hyrjes për në panairë dhe kongrese, nëse do të frekuentohen të tillë;

b) për udhëtimet që ndërmerren për qëllime studimi ose lloje të tjera trajnimi:

I. një certifikatë regjistrimi në një institut mësimdhënieje për qëllimet e frekuentimit të kurseve profesionale ose teorike në kuadër të trajnimit bazë ose të mëtejshëm;

II. kartat e studentëve ose certifikatat për kurset e ndjekura;

c) për udhëtime që ndërmerren për qëllime turistike ose për arsye private:

I. dokumente mbështetëse në lidhje me akomodimin:

— një ftesë nga pritësi, nëse qëndroni te një i tillë,

— një dokument mbështetës nga subjekti që ofron akomodimin ose ndonjë dokument tjetër të përshtatshëm që tregon akomodimin e parashikuar;

II. dokumente mbështetëse në lidhje me itinerarin:

konfirmimi i rezervimit të një udhëtimi të organizuar ose çdo dokument tjetër i përshtatshëm që tregon planet e parashikuara të udhëtimit;

III. dokumente mbështetëse në lidhje me kthimin:

një biletë kthimi ose biletë vajtje-ardhje.

d) për udhëtime që ndërmerren për evenimente politike, shkencore, kulturore, sportive ose fetare, ose për arsye të tjera:

ftesat, biletat e hyrjes, regjistrimet ose programet që tregojnë, kur është e mundur, emrin e organizatës pritëse dhe kohëzgjatjen e qëndrimit ose ndonjë dokument tjetër i përshtatshëm që tregon qëllimin e vizitës.

---

## SHTOJCA II

### REGJISTRIMI I INFORMACIONIT

Në çdo pikë të kalimit kufitar, të gjitha informacionet e shërbimit dhe çdo informacion tjetër me rëndësi të veçantë regjistrohen manualisht ose në formë elektronike. Informacioni që duhet të regjistrohet përfshin në veçanti:

a) emrin e rojës kufitare përgjegjëse në nivel lokal për verifikimet kufitare dhe të oficerëve të tjerë në secilin ekip;

b) lehtësirat për verifikimin e personave, që aplikohen sipas nenit 8;

c) lëshimin, në kufi, të dokumenteve në vend të pasaportave dhe të vizave;

d) personat e ndaluar dhe ankesat (veprat penale dhe shkeljet administrative);

e) personat, të cilëve u është refuzuar hyrja në përputhje me nenin 13 (arsyet për refuzimin dhe kombësitë);

f) kodet e sigurisë së vulave hyrëse dhe dalëse, identiteti i rojës kufitare të cilit i përket një vulë në çdo kohë ose turn të caktuar dhe informacioni në lidhje me vulat e humbura dhe të vjedhura;

g) ankesat nga personat që u nënshtrohen verifikimeve;

h) masa të tjera policore ose gjyqësore me rëndësi të veçantë;


I. ngjarje të pazakonta.

---

## SHTOJCA III

### TABELAT MODEL QË TREGOJNË KORSITË NË PIKAT E KALIMIT KUFITAR


#### PJESA A








25



25







---

## SHTOJCA IV

### VENDOSJA E VULAVE

1. Dokumentet e udhëtimit të shtetasve të vendeve të treta vulosen rregullisht në hyrje dhe dalje, në përputhje me nenin 10. Specifikat e këtyre vulave përcaktohen në Vendimin e Komitetit Ekzekutiv të Shengenit SCH/COM-EX (94) 16, i rishikuar dhe SCH/Gem-Handb (93) 15 (KONFIDENCIALE).

2. Kodet e sigurisë në vula ndryshohen në intervale të rregullta që nuk tejkalojnë një muaj.

3. Në hyrje dhe dalje të shtetasve të vendeve të treta që i nënshtrohen detyrimit për vizë, vula, kur është e mundur, vendoset në një vend të tillë që të mbulojë cepin e vizës, pa ndikuar në lexueshmërinë e informacioneve të vizës ose në tiparet e sigurisë së vizës së ngjitur. Nëse duhet të vendosen disa vula (për shembull në rastin e një vize me shumë kalime, kjo bëhet në faqen përballë faqes ku është vendosur viza.

Nëse kjo faqe nuk mund të përdoret, vula vendoset në faqen pasuese. Në zonën e lexueshme nga makineria nuk vendosen vula.

4. Shtetet anëtare caktojnë pika kontakti kombëtare përgjegjëse për të shkëmbyer informacione për kodet e sigurisë së vulave të hyrjes dhe të daljes që përdoren në pikat e kalimit kufitar dhe njoftojnë shtetet e tjera anëtare, Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit dhe Komisionin për sa më lart. Këto pika kontakti kanë akses të menjëhershëm në informacionet që lidhen me vulat e përbashkëta të hyrjes dhe të daljes që përdoren në kufirin e jashtëm të shtetit anëtar në fjalë, dhe në veçanti, në informacionet që lidhen me sa më poshtë:

- a) pikën e kalimit kufitar të cilës i është caktuar një vulë;
- b) identitetin e rojës kufitare të cilit i është caktuar një vulë e caktuar në një kohë të caktuar;
- c) kodin e sigurisë së një vule të caktuar në një kohë të caktuar.

Çdo ankesë në lidhje me vulat e përbashkëta të hyrjes dhe daljes bëhet nëpërmjet këtyre pikave kombëtare të kontaktit.

Gjithashtu, pikat kombëtare të kontaktit i përcjellin menjëherë pikave të tjera të kontaktit, Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit dhe Komisionit informacionin që lidhet me një ndryshim të pikave të kontaktit si edhe me vulat e humbura dhe të vjedhura.

---

## SHTOJCA V

### PJESA A

#### PROCEDURAT PËR REFUZIMIN E HYRJES NË KUFIT

1. Në rastet kur refuzon hyrjen, roja kufitare kompetente:

a) Plotëson formularin standard për refuzimin e hyrjes, siç tregohet në pjesën B. Shtetasi përkatës i vendit të tretë nënshkruan formularin dhe merr një kopje të formularit të nënshkruar. Në rastet kur shtetasi i një vendi të tretë refuzon të nënshkruajë, roja kufitare e tregon këtë refuzim në seksionin e formularit "komente";

b) vendos një vulë hyrjeje në pasaportë, të anuluar me një kryq me bojë të zezë që nuk fshihet dhe shkruan përbri saj, në krahun e djathtë, po me bojë të zezë që nuk fshihet, shkronjat që përkojnë me arsyet për refuzimin e hyrjes, lista e të cilave paraqitet në formularin standard të lartpërmendur për refuzimin e hyrjes;

c) anulon vizën duke vendosur një vulë ku thuhet "ANULOHET" në rastet e përmendura në paragrafin 2. Në këtë rast, tipari optik i ndryshueshëm i vizës, tipari i sigurisë "efekti i imazhit të fshehur" si edhe termi "viza" fshihen duke i vendosur një kryq për të parandaluar ndonjë keqpërdorim të mëvonshëm. Roja kufitare lajmëron menjëherë autoritetet e tij qendrore për këtë vendim;

d) regjistron çdo refuzim të hyrjes në një regjistër ose në një listë duke deklaruar identitetin dhe kombësinë e shtetasit përkatës të një vendi të tretë, referencat e dokumentit që autorizon shtetasin e një vendi të tretë të kalojë kufirin dhe arsyet për dhe datën e refuzimit të hyrjes;

## 2. Viza anulohet në rastet e mëposhtme:

a) nëse mbajtësi i vizës është subjekt i një njoftimi në SIS që synon refuzimin e hyrjes, përveç se kur ai mban një vizë ose një vizë për rihyrje të lëshuar nga një prej shteteve anëtare dhe dëshiron të hyjë për qëllime transiti për të arritur në territorin e shtetit anëtar që ka lëshuar dokumentin;

b) kur ka arsye serioze për të besuar se viza është marrë në mënyrë mashtruese.

Megjithatë, paaftësia e shtetasit të një vendi të tretë për të paraqitur në kufi një ose më shumë prej dokumenteve mbështetëse që përmenden në nenin 5, paragrafi 2 nuk çojnë automatikisht në një vendim për anulimin e vizës.

3. Nëse shtetasi i një vendi të tretë të cilit i është refuzuar hyrja, sillet në kufi nga një transportues, autoriteti lokal përgjegjës:

a) urdhëron transportuesin për të marrë në ngarkim shtetasin e vendit të tretë dhe ta transportojë atë pa vonesë në vendin e tretë nga i cili ai ka ardhur, në vendin e tretë që ka lëshuar dokumentin që e autorizon atë të kalojë kufirin ose në një vend tjetër të tretë ku atij i garantohet pranimi, ose për të gjetur mënyra për transport të mëtejshëm, në përputhje me nenin 26 të Konventës së Shengenit dhe Direktivën e Këshillit 2001/51/KE, datë 28 qershor 2001, që plotëson dispozitat e nenit 26 të Konventës për zbatimin e Marrëveshjes Shengen të 14 qershorit 1985<sup>26</sup>;

b) në pritje të transportit të mëtejshëm, merr masat e përshtatshme, në pajtim me legjislacionin e brendshëm dhe duke marrë në konsideratë rrethanat lokale, për të parandaluar që shtetasit e vendeve të treta, të cilëve i është refuzuar hyrja, të hyjnë në mënyrë të jashtëligjshme.

4. Nëse ka arsye për të refuzuar hyrjen për një shtetas të vendit të tretë dhe për ta arrestuar atë, roja kufitare kontakton autoritetet përgjegjëse për të marrë një vendim për masat që duhet të merren në përputhje me legjislacionin e brendshëm.

## PJESA B

### FORMULARI STANDARD PËR REFUZIMIN E HYRJES NË KUFI



---

## SHTOJCA VI

### RREGULLAT SPECIFIKE PËR LLOJET E NDRYSHME TË KUFIJVE DHE MJETET E NDRYSHME TË TRANSPORTIT QË PËRDOREN PËR KALIMIN E KUFIJVE TË JASHTME TË SHTETEVE ANËTARE

#### 1. Kufijtë tokësorë

##### 1.1. Verifikimet në trafikun rrugor

1.1.1. Për të garantuar verifikime efikase të personave, ndërkohë që garantohet siguria dhe qarkullimi normal i trafikut rrugor, lëvizjet në pikat e kalimit kufitar rregullohen në mënyrë të përshtatshme. Kur është e nevojshme, shtetet anëtare mund të lidhin marrëveshje dypalëshe për të kanalizuar dhe bllokuar qarkullimin. Ata informojnë Komisionin për këtë, sipas nenit 37.

1.1.2. Në kufijtë tokësorë, shtetet anëtare, kur e gjykojnë të përshtatshme dhe nëse e lejojnë rrethanat, instalojnë ose përdorin korsi të ndara në disa pika të kalimit kufitar, në përputhje me nenin 9.

Korsitë e ndara mund të hiqen në çdo kohë nga autoritetet kompetente të shteteve anëtare, në rrethana përjashtimore dhe kur kjo bëhet e nevojshme për shkak të gjendjes së qarkullimit dhe kushteve të infrastrukturës.

Shtetet anëtare mund të bashkëpunojnë me vendet fqinje për të vendosur korsi të ndara në pikat e kalimit të kufijve të jashtme.

1.1.3. Si rregull i përgjithshëm, personat që udhëtojnë me automjete mund të qëndrojnë brenda automjetit gjatë verifikimeve. Megjithatë, nëse kërkohet nga rrethanat, personave mund t'u kërkohet që të zbresin nga automjeti i tyre. Verifikimet e imtësishme, kur e lejojnë rrethanat lokale, kryhen në zonat e përcaktuara për këtë qëllim. Në interes të sigurisë së stafit, verifikimet kryhen nga dy roja kufitare kur kjo është e mundur.

##### 1.2. Verifikimet në trafikun hekurudhor

1.2.1. Për trenat që kalojnë kufijtë e jashtëm, duke përfshirë trenat e mallrave ose trenat bosh, kryhen verifikimet e udhëtarëve dhe të stafit hekurudhor. Këto verifikime kryhen në një prej dy mënyrave të mëposhtme:

— në platformë, në stacionin e parë të mbërritjes ose të nisjes në territorin e një shteti anëtar,

— në bordin e trenit, gjatë transitit.

Shtetet anëtare mund të lidhin marrëveshje dypalëshe për mënyrën e kryerjes së këtyre verifikimeve. Ata informojnë Komisionin për këtë, sipas nenit 37.

1.2.2. Duke deroguar nga pika 1.2.1 dhe për të lehtësuar qarkullimin hekurudhor të trenave të shpejtësisë së lartë që transportojnë udhëtar, shtetet anëtare që janë në itinerarin e këtyre trenave që vijnë nga vendet e treta mund të vendosin, nëpërmjet marrëveshjeve të përbashkëta me këto vende të treta, që të kryejnë verifikimin e personave në trenat që vijnë nga vendet e treta në një prej mënyrave të mëposhtme:

- në stacionet e një vendi të tretë ku personat hipin në tren,
- në stacionet ku personat zbresin brenda territorit të shteteve anëtare,
- në bordin e trenit, gjatë transitit ndërmjet stacioneve në territorin e shteteve anëtare, me kusht që personat të qëndrojnë në bordin e trenit në stacionet e mëparshme.

1.2.3. Për sa u përket trenave të shpejtësisë së lartë nga vende të treta që ndalojnë disa herë në territorin e shteteve anëtare, nëse transportuesi hekurudhor është në gjendje të marrë udhëtarë vetëm për pjesën e mbetur të udhëtimit brenda territorit të shteteve anëtare, këta udhëtarë i nënshtrohen verifikimeve të hyrjes, ose në tren ose në stacionin e vend mbërritjes, përveçse kur verifikimet janë kryer sipas pikave 1.2.1 ose 1.2.2, ndarja e parë.

Personat që dëshirojnë të marrin trenin vetëm për pjesën e mbetur të udhëtimit brenda territorit të shteteve anëtare, marrin një njoftim të qartë përpara nisjes së trenit se ata do t'i nënshtrohen verifikimit në hyrje gjatë udhëtimit ose në stacionin e mbërritjes.

1.2.4. Kur udhëtojnë në drejtim të kundërt, personat që janë në tren i nënshtrohen verifikimeve në dalje me të njëjtat masa.

1.2.5. Roja kufitare mund të urdhërojë inspektimin e hapësirave të bagazheve nëse është e nevojshme, me ndihmën e inspektorit të trenit, për t'u siguruar se aty nuk janë fshehur persona ose sende që janë objekt i verifikimeve kufitare.

1.2.6. Kur ka arsye për të besuar se në tren janë fshehur persona që janë raportuar ose dyshohen se kanë kryer një vepër penale, ose shtetasit e vendeve të treta që synojnë të hyjnë në mënyrë të paligjshme, roja kufitare, nëse nuk ka kompetencë për të vepruar, në përputhje me dispozitat e brendshme, njofton shtetin anëtar drejt të cilit ose brenda territorit të së cilit po lëviz treni.

## 2. Kufijtë ajrorë

### 2.1. Procedurat për verifikimet në aeroportet ndërkombëtare

2.1.1. Autoritetet kompetente të shteteve anëtare sigurohen që operatori i aeroportit të marrë masat e kërkuara për të ndarë fizikisht qarkullimin e udhëtarëve të fluturimeve të brendshme nga qarkullimi i udhëtarëve të fluturimeve të tjera. Për këtë qëllim, në të gjitha aeroportet ndërkombëtare ngrihet infrastruktura e përshtatshme.

2.1.2. Vendi ku kryhen verifikimet kufitare përcaktohet në përputhje me procedurën e mëposhtme:

a) udhëtarët e fluturimeve nga një vend i tretë, të cilët marrin një fluturim të brendshëm i nënshtrohen një verifikimi në hyrje në aeroportin e mbërritjes së fluturimit nga vendi i tretë. Udhëtarët e një fluturimi të brendshëm, të cilët marrin një fluturim nga një vendi i tretë (udhëtarë të transferuar) i nënshtrohen një verifikimi në dalje në aeroportin nga ku nisët fluturimi i fundit;

b) për fluturimet nga ose drejt vendeve të treta ma udhëtarë të transferuar dhe fluturimet që bëjnë më shumë se një ndalesë të shkurtër në aeroportet e shteteve anëtare ku nuk ka ndryshim avioni:

I. udhëtarët e fluturimeve nga ose drejt vendeve të treta ku nuk ka transferim paraprak ose pasues brenda territorit të shteteve anëtare i nënshtrohen një verifikimi në hyrje në aeroportin e hyrjes dhe një verifikimi në dalje në aeroportin e daljes;

II. udhëtarët e fluturimeve nga ose drejt vendeve të treta me më shumë se një ndalesë të shkurtër në territorin e shteteve anëtare, kur nuk ka ndryshim avioni (udhëtarë transiti) dhe me kusht që udhëtarët të mos mund të hipin në avion për pjesën e mbetur të udhëtimit në territorin e shteteve anëtare, i nënshtrohen një verifikimi në hyrje në aeroportin e mbërritjes dhe një verifikimi në dalje në aeroportin e nisjes;

III. kur një linjë ajrore, për fluturimet nga vendet e treta me më shumë se një ndalesë brenda territorit të shteteve anëtare, mund të marrë udhëtarë vetëm për pjesën e mbetur të udhëtimit brenda atij territori, udhëtarët i nënshtrohen një verifikimi në dalje në aeroportin e nisjes dhe një verifikimi në hyrje në aeroportin e mbërritjes.

Verifikimet e udhëtarëve, të cilët, gjatë këtyre ndalesave, janë në bordin e avionit dhe nuk kanë hipur në territorin e shteteve anëtare, kryhen në përputhje me germën "b", pika (ii). Për kategorinë e fluturimeve kur vendi i mbërritjes është një vend i tretë zbatohet procedura e anasjelltë.

2.1.3. Verifikimet kufitare normalisht nuk kryhen në avion ose në portë, përveç se kur kjo është e justifikuar mbi bazën e një vlerësimi të rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm. Për të garantuar që në aeroportet e përcaktuara si pika të kalimit kufitar personat të verifikohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenet 6 deri në 13, shtetet anëtare sigurohen që autoritetet aeroportuale të marrin masat e kërkuara për të drejtuar trafikun e udhëtarëve drejt mjediseve të rezervuara për verifikime.

Shtetet anëtare sigurohen që operatori aeroportual të marrë masat e nevojshme për të parandaluar që personat e paautorizuar të hyjnë dhe të largohen nga zonat e rezervuara, për shembull nga zona e transitit. Normalisht, verifikimet nuk kryhen në zonën e transitit, përveçse kur kjo justifikohet mbi bazën e një vlerësimi të rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm; verifikimet në këtë zonë mund të kryhen veçanërisht për personat që duhet të pajisjen me një vizë transit në aeroport, për të verifikuar nëse e kanë një vizë të tillë.

2.1.4. Kur, në rastet e forcës madhore ose të rrezikut të pashmangshëm ose në zbatim të udhëzimeve të autoriteteve, avioni që vjen nga një vend i tretë duhet të ulet në një aeroport i cili nuk është pikë kalimi kufitar, ky avion mund të vazhdojë fluturimin e tij vetëm pasi ka marrë autorizimin nga rojat kufitare dhe nga doganat. E njëjta procedurë zbatohet edhe kur një avion që

vjen nga një vend i tretë ulet pa leje. Në çdo rast, për verifikimin e personave në këta avionë zbatohen nenet 6 deri në 13.

## 2.2. Procedurat për verifikimet në aerodrome

2.2.1. Merren masa që personat të verifikohen, në përputhje me nenet 6 deri në 13, edhe në aeroporte që nuk kanë statusin e aeroportit ndërkombëtar sipas legjislacionit të brendshëm përkatës (aerodrome), por përmes të cilëve janë autorizuar fluturimet nga ose drejt vendeve të treta.

2.2.2. Duke deroguar nga pika 2.1.1, nuk është e nevojshme që të merren masat e përshtatshme në aerodrome për të garantuar që flukset e udhëtarëve nga fluturimet e brendshme ose fluturime të tjera të ndahen, pa cenuar Rregulloren (KE) nr. 2320/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 16 dhjetor 2002, "Për përcaktimin e rregullave të përbashkëta në fushën e sigurisë së aviacionit civil"<sup>27</sup>. Gjithashtu, kur trafiku është i ulët, nuk është nevojta që rojat kufitare të jenë të pranishme gjatë gjithë kohës, nëse garantohet që personeli i nevojshëm mund të vihet në dispozicion brenda kohës së nevojshme.

2.2.3. Kur prania e rojave kufitare në aerodrom nuk garantohet gjatë gjithë kohës, drejtori i aerodromit i dërgon rojave kufitare një njoftim të përshtatshëm për mbërritjen ose nisjen e avionëve në fluturime nga ose drejt vendeve të treta.

## 2.3. Verifikimet e personave në fluturimet private

2.3.1. Në rastin e fluturimeve private nga ose drejt vendeve të treta, kapiteni i transmeton rojave kufitare të shtetit anëtar të mbërritjes dhe, sipas rastit, shtetit anëtar të hyrjes së parë, përpara ngritjes së avionit, një deklaratë të përgjithshme që përfshin, ndër të tjera, planin e fluturimit në përputhje me shtojcën 2 të Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar dhe informacionin në lidhje me identitetin e udhëtarëve.

2.3.2. Kur fluturimet private që vijnë nga një vend i tretë dhe shkojnë drejt një shteti anëtar bëjnë ndalesa në territorin e shteteve të tjera anëtare, autoritetet kompetente të shtetit anëtar të hyrjes kryejnë verifikimet kufitare dhe vendosin vulë në deklaratën e përgjithshme të përmendur në pikën 2.3.1.

2.3.3. Kur ka pasiguri në lidhje me faktin nëse një fluturim vjen ekskluzivisht nga dhe shkon vetëm drejt territoreve të shteteve anëtare pa ndalesa në territorin e një vendi të tretë, autoritetet kompetente i kryejnë verifikimet e personave në aeroporte dhe aerodrome në përputhje me pikat 2.1 dhe 2.2.

2.3.4. Masat për hyrjen dhe daljen e avionëve pa motor, avionëve të lehtë, helikopterëve, avionëve të vegjël që mund të fluturojnë vetëm në distanca të shkurtra dhe për balonat fluturuese përcaktohen në legjislacionin e brendshëm dhe, sipas rastit, në marrëveshjet dypalëshe.

## 3. Kufijtë detarë

### 3.1. Procedurat e përgjithshme të verifikimit të trafikut detar



3.1.1. Verifikimet në anije kryhen në portin e mbërritjes ose të nisjes, në bordin e anijes ose në zonën e veçuar për këtë qëllim, që ndodhet në afërsi të mjetit të lundrimit. Megjithatë, në përputhje me marrëveshjet e arritura për këtë çështje, verifikimet mund të kryhen edhe gjatë kalimeve ose, gjatë mbërritjes ose nisjes së anijes në territorin e një vendi të tretë.

Qëllimi i verifikimeve është që të garantohet se ekuipazhi dhe udhëtarët përmbushin kushtet e përcaktuara në nenin 5, pa cenuar nenin 19, paragrafi 1, germa "c".

3.1.2. Kapiteni i anijes, ose në mungesë të tij, individ i ose korporata që përfaqëson zotëruesin e anijes në të gjitha çështjet që lidhen me detyrat për përshtatshmërinë e anijes (agjenti i zotëruesit të anijes), harton një listë, në dy kopje, të ekuipazhit dhe të çdo udhëtari. Jo më vonë se gjatë mbërritjes në port, ai ia dorëzon listat rojave kufitare. Nëse, për arsye të forcës madhore, lista ose listat nuk mund t'i dërgohen rojave kufitare, një kopje i dërgohet postës kufitare përkatëse ose autoritetit portual, i cili ia përcjell ato menjëherë rojave kufitare.

3.1.3. Një kopje e dy listave të nënshkruara siç duhet nga roja kufitare i kthehet kapitenit të anijes, i cili e paraqet atë sipas kërkesës, kur të ndodhet në port.

3.1.4. Kapiteni i anijes, ose në mungesë të tij, agjenti i zotëruesit të anijes i raporton menjëherë autoritetit kompetent çdo ndryshim në përbërjen e ekuipazhit ose në numrin e udhëtarëve.

Gjithashtu, kapiteni njofton autoritetet kompetente, menjëherë dhe nëse është e mundur edhe përpara se anija të hyjë në port, për praninë e udhëtarëve pa biletë. Megjithatë, udhëtarët pa biletë mbesin nën përgjegjësinë e kapitenit të anijes.

3.1.5. Kapiteni i anijes njofton rojat kufitare për nisjen e anijes në kohë dhe në përputhje me rregullat në fuqi në portin përkatës; nëse ai nuk ka mundësi t'i njoftojë ata, ai këshillohet me autoritetin portual përkatës. Kopja e dytë e listave të plotësuara dhe të nënshkruara më parë i kthehet rojave kufitare ose autoriteteve portuale.

## 3.2. Procedurat specifike të verifikimit për lloje të caktuara anijesh

### Anijet turistike

3.2.1. Kapiteni i anijeve turistike, ose në mungesë të tij, agjenti i zotëruesit të anijes, i transmeton rojave kufitare përkatëse itinerarin dhe programin e udhëtimit turistik, të paktën 24 orë përpara se të largohet nga porti i nisjes dhe përpara mbërritjes në secilin prej porteve në territorin e shteteve anëtare.

3.2.2. Nëse itinerari i një anijeje turistike përfshin vetëm portet që ndodhen në territorin e shteteve anëtare, duke deroguar nga nenet 4 dhe 7, nuk kryhet asnjë verifikim kufitar dhe anija turistike mund të ndalojë në porte që nuk janë pika të kalimit kufitar.

Megjithatë, bazuar në një vlerësim të rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm, ekuipazhi dhe udhëtarët e këtyre anijeve mund të verifikohen.

3.2.3. Nëse itinerari i anijes turistike përfshin porte që ndodhen në territorin e shteteve anëtare dhe porte që ndodhen në vende të treta, duke deroguar nga neni 7, verifikimet kufitare kryhen si në vijim:

a) kur anija turistike vjen nga një port që ndodhet në një vend të tretë dhe ndalon për herë të parë në një port që ndodhet në territorin e një shteti anëtar, ekuipazhi dhe udhëtarët i nënshtrohen verifikimeve në hyrje bazuar në listat emërore të ekuipazhit dhe udhëtarëve, siç përmenden në pikën 3.2.4.

Udhëtarët që zbresin në breg i nënshtrohen verifikimeve në hyrje në përputhje me nenin 7, përveç se kur vlerësimi i rreziqeve në lidhje me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm tregon se nuk është nevoja që të kryhen këto verifikime;

b) kur anija turistike vjen nga një port që ndodhet në një vend të tretë dhe ndalon sërisht në një port që ndodhet në territorin e një shteti anëtar, ekuipazhi dhe udhëtarët i nënshtrohen verifikimeve në hyrje bazuar në listat emërore të ekuipazhit dhe udhëtarëve, siç përmenden në pikën 3.2.4, për aq sa këto lista janë modifikuar që kur anija turistike ka ndaluar në portin e mëparshëm që ndodhej në territorin e një shteti anëtar.

Udhëtarët që zbresin në breg i nënshtrohen verifikimeve në hyrje në përputhje me nenin 7, përveç se kur vlerësimi i rreziqeve në lidhje me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm tregon se nuk është nevoja që të kryhen këto verifikime;

c) kur anija turistike vjen nga një port që ndodhet në një shtet anëtar dhe ndalon në një port të tillë, udhëtarët që zbresin në breg i nënshtrohen verifikimeve në përputhje me nenin 7, nëse diçka e tillë kërkohet nga vlerësimi i rreziqeve në lidhje me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm;

d) kur një anije turistike niset nga një port që ndodhet në një shtet anëtar drejt një porti të një vendi të tretë, ekuipazhi dhe udhëtarët i nënshtrohen verifikimeve në dalje bazuar në listat emërore të ekuipazhit dhe udhëtarëve.

Kur diçka e tillë kërkohet nga një vlerësim i rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm, udhëtarët që hipin në anije i nënshtrohen verifikimeve në dalje në përputhje me nenin 7;

e) kur një anije turistike niset nga një port që ndodhet në një shtet anëtar drejt një porti po në një shtet anëtar, nuk kryhen verifikime në dalje

Megjithatë, bazuar në një vlerësim të rreziqeve që lidhen me sigurinë e brendshme dhe imigracionin e paligjshëm, ekuipazhi dhe udhëtarët e këtyre anijeve mund të verifikohen.

3.2.4. Listat emërore të ekuipazhit dhe udhëtarëve përfshijnë:

a) emrin dhe mbiemrin;

b) datën e lindjes;

c) kombësinë;

d) numrin dhe llojin e dokumentit të udhëtimit dhe, sipas rastit, numrin e vizës.

Kapiteni i anijes turistike, ose në mungesë të tillë, agjenti i zotëruesit të anijes i transmeton rojave kufitare përkatëse listat emërore të paktën 24 orë përpara mbërritjes në secilin port në territorin e shteteve anëtare, ose kur udhëtimi drejt këtij porti zgjat më pak se 24 orë, menjëherë pasi embarkimi ka përfunduar në portin e mëparshëm.

Lista emërore vulozet në portin e parë të hyrjes në territorin e shteteve anëtare dhe në të gjitha rastet në vijim nëse lista modifikohet. Lista emërore merret në konsideratë për vlerësimin e rreziqeve, siç përmendet në pikën 3.2.3.

#### Lundrimi argëtues

3.2.5. Duke deroguar nga nenet 4 dhe 7, personat në bordin e mjeteve të lundrimit argëtues që vijnë nga ose nisen drejt një porti që ndodhet në një shtet anëtar, nuk i nënshtrohen verifikimeve kufitare dhe mund të futen në një port që nuk është pikë kalimi kufitar.

Megjithatë, sipas vlerësimit të rreziqeve të imigracionit të paligjshëm, dhe në veçanti kur vija bregdetare e një vendi të tretë ndodhet në afërsi të territorit të shtetit anëtar në fjalë, kryhen verifikimet e këtyre personave dhe/ose kontrolli fizik i mjetit të lundrimit argëtues.

3.2.6. Duke deroguar nga neni 4, një mjet lundrimi argëtues që vjen nga një vend i tretë, në raste të veçanta, hyn në një port që nuk është pikë e kalimit kufitar. Në këtë rast, personat në bord njoftojnë autoritetet portuale me qëllim që të autorizohen për të hyrë në atë port. Autoritetet portuale kontaktojnë autoritetet në portin më të afërt të caktuar si pikë e kalimit kufitar me qëllim që të raportojnë mbërritjen e mjetit të lundrimit. Deklarata në lidhje me udhëtarët bëhet duke i dorëzuar autoriteteve portuale listën e personave në bord. Kjo listë u vihet në dispozicion rojave kufitare menjëherë pas mbërritjes.

Gjithashtu, nëse për arsye të forcës madhore mjete i lundrimit argëtues që vjen nga një vend i tretë duhet të ndalojë në një port që nuk është pikë e kalimit kufitar, autoritetet portuale kontaktojnë autoritetet në portin më të afërt të caktuar si pikë e kalimit kufitar me qëllim që të raportojnë praninë e mjetit të lundrimit.

3.2.7. Gjatë këtyre verifikimeve, dorëzohet një dokument që përmban të gjitha karakteristikat teknike të mjetit të lundrimit dhe emrat e personave në bord. Një kopje e këtij dokumenti i jepet autoriteteve të portit të hyrjes dhe të daljes. Për sa kohë që mjeti i lundrimit qëndron në ujërat territoriale të një shteti anëtar, një kopje e këtij dokumenti mbahet bashkë me dokumentet e anijes.

#### Peshkimi bregdetar

3.2.8. Duke deroguar nga nenet 4 deri në 7, ekuipazhet e anijeve të peshkimit bregdetar që kthehen çdo ditë ose brenda 36 orësh në portin e regjistrimit ose në çdo port tjetër që ndodhet në territorin e shteteve anëtare pa ndaluar në një port që ndodhet në territorin e një vendi të tretë, nuk verifikohen në mënyrë sistematike. Megjithatë, për të përcaktuar shpeshësinë e verifikimeve

që duhet të kryhen, merret në konsideratë vlerësimi i rreziqeve të imigracionit të jashtëligjshëm, dhe veçanërisht kur vija bregdetare e një vendi të tretë ndodhet në afërsi të territorit të këtij shteti anëtar. Sipas këtyre rreziqeve, kryhen verifikimet e personave dhe/ose kontrolli fizik i mjetit të lundrimit.

3.2.9. Anëtarët e ekuipazhit të anijeve të peshkimit bregdetar që nuk janë regjistruar në një port që ndodhet në territorin e një shteti anëtar, verifikohen në përputhje me dispozitat që lidhen me marinarët.

Kapiteni i anijes njofton autoritetet kompetente për çdo ndryshim të listës së ekuipazhit dhe për praninë e ndonjë udhëtari.

#### Linjat e trageteve

3.2.10. Verifikimet bëhen për personat që ndodhen në bordin e linjave të tragetit në portet që ndodhen në vende të treta. Zbatohen rregullat e mëposhtme:

- a) kur është e mundur, shtetet anëtare ofrojnë korsi të ndara, në përputhje me nenin 9;
- b) verifikimet e udhëtarëve këmbësorë kryhen individualisht;
- c) verifikimet për personat që udhëtojnë me automjet kryhen ndërkohë që ata janë në automjet;
- d) udhëtarët e tragetit që udhëtojnë me autobus konsiderohen si udhëtarë këmbësorë. Këta udhëtarë duhet të dalin nga autobusi gjatë verifikimeve;
- e) verifikimet e drejtuesve të automjeteve të rënda për transport mallrash dhe personat që i shoqërojnë kryhen ndërkohë që këta persona qëndrojnë në automjet. Në parim, këto verifikime organizohen të ndara nga verifikimet për udhëtarët e tjerë;
- f) për të garantuar që verifikimet të kryhen shpejt, vendoset një numër i përshtatshëm portash;
- g) për të zbuluar veçanërisht imigrantët e jashtëligjshëm, kryhen kontrole të rastësishme në mjetet e transportit që përdoren nga udhëtarët dhe, sipas rastit, në ngarkesat dhe mallrat e tjera që ndodhen në mjetin e transportit;
- h) anëtarët e ekuipazhit të trageteve trajtohen në të njëjtën mënyrë si anëtarët e ekuipazhit të anijeve tregtare.

#### 4. Lundrimi në ujërat e brendshme

4.1. "Lundrimi në ujërat e brendshme që përfshin kalimin e një kufiri të brendshëm" mbulon përdorimin, për qëllime biznesi ose argëtimi, të të gjitha llojeve të varkave dhe mjeteve pluskuese në lumenj, kanale dhe liqene.

4.2. Për sa i përket varkave që përdoren për qëllime biznesi, kapiteni dhe personat e punësuar në bordin e saj, të cilët janë pjesë e listës së ekuipazhit dhe familjarë të atyre personave që jetojnë në bord konsiderohen si anëtarë të ekuipazhit ose si të barasvlershëm me ta.

4.3. Dispozitat përkatëse të pikave 3.1 deri në 3.2 zbatohen rast pas rasti për verifikimet në lundrimin në ujërat e brendshme.

---

## SHTOJCA VII

### RREGULLA TË VEÇANTA PËR DISA KATEGORI PERSONASH

#### 1. Krerët e shteteve

Duke deroguar nga neni 5 dhe nenet 7 deri në 13, krerët e shteteve dhe anëtarët e delegacioneve të tyre, mbërritja dhe largimi i të cilëve i janë njoftuar rojave kufitare përmes rrugëve diplomatike, nuk mund t'i nënshtrohen verifikimeve në kufi.

#### 2. Pilotët e avionëve dhe anëtarët e tjerë të ekuipazhit

2.1. Në shmangie të nenit 5, mbajtësit e një licence piloti ose të një certifikate të anëtarit të ekuipazhit, siç parashikohet në shtojcën 9 të Konventës së Aviacionit Civil të 7 dhjetorit 1944, gjatë ushtrimit të detyrave të tyre dhe mbi bazën e këtyre dokumenteve, mund:

a) të hipin dhe të zbresin në aeroportin e ndalesës ose në aeroportin e mbërritjes që ndodhet në territorin e një shteti anëtar;

b) të hyjnë në territorin e bashkisë së aeroportit të ndalesës ose të aeroportit të mbërritjes, që ndodhet në territorin e një shteti anëtar;

c) të shkojnë, me çdo lloj mënyre transporti, në një aeroport që ndodhet në territorin e një shteti anëtar me qëllim që të hipin në një avion që niset po nga ai aeroport.

Në të gjitha rastet e tjera, duhet të përmbushen kërkesat e parashikuara në nenin 5, paragrafi 1.

2.2. Për verifikimet e anëtarëve të ekuipazhit të avionit zbatohen nenet 6 deri në 13. Kur është e mundur, i jepet përparësi verifikimeve të ekuipazheve të avionëve. Në mënyrë specifike, ata verifikohen ose përpara udhëtarëve, ose në vende të veçanta të rezervuara për këtë qëllim. Në shmangie të nenit 7, anëtarët e ekuipazhit që janë të njohur për stafin përgjegjës për kontrollin kufitare, mund t'i nënshtrohen vetëm verifikimeve të rastësishme gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

#### 3. Marinarët

3.1. Duke deroguar nga nenet 4 dhe 7, shtetet anëtare mund të autorizojnë marinarët që zotërojnë një dokument identifikimi si marinar të lëshuar në përputhje me Konventën e Gjenevës së 19 qershorit 2003 (nr. 185), Konventën e Londrës së 9 prillit 1965 dhe legjislacionin e

brendshëm përkatës, që të hyjnë në territorin e shteteve anëtare duke dalë në breg për të qëndruar në zonën e portit ku ndalojnë anijet e tyre ose në bashkitë e portit pa u paraqitur në pikat e kalimit kufitar, me kusht që ata të jenë pjesë e listës së ekuipazhit të anijes së cilës i përkasin, listë e cila është dorëzuar paraprakisht për t'u verifikuar nga autoritetet kompetente.

Megjithatë, sipas vlerësimit të rreziqeve për sigurinë e brendshme dhe të emigracionit të paligjshëm, përpara se të dalin në breg marinarët i nënshtrohen një verifikimi nga rojat kufitare sipas nenit 7.

Nëse një marinar përbën kërcënim për politikën publike, sigurinë e brendshme ose shëndetin publik, atij mund t'i refuzohet leja për të dalë në breg.

3.2. Marinarët që synojnë të qëndrojnë jashtë bashkive që ndodhen në afërsi të porteve, duhet të përmbushin kushtet për hyrjen në territorin e shteteve anëtare, siç përcaktohen në nenin 5, paragrafi 1.

4. Mbjtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit dhe anëtarët e organizatave ndërkombëtare

4.1. Duke marrë në konsideratë privilegjet e veçanta ose imunitetet që ata gëzojnë, mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit të lëshuara nga vendet e treta ose nga qeveritë e tyre dhe që njihen nga shtetet anëtare, si edhe mbajtësit e dokumenteve të lëshuara nga organizatat ndërkombëtare që paraqiten në pikën 4.4, të cilët udhëtojnë për të ushtruar detyrat e tyre, mund të kenë përparësi ndaj udhëtarëve të tjerë në pikat e kalimit kufitar, edhe pse, sipas rastit, ata vazhdojnë t'i nënshtrohen kërkesës për vizë.

Në shmangie të nenit 5, paragrafi 1, germa "c", personave që mbajnë këto dokumente nuk u kërkohet që të vërtetojnë se kanë mjete të mjaftueshme jetese.

4.2. Nëse një person që paraqitet në kufirin e jashtëm kërkon që t'i jepen privilegje, imunitete dhe përjashtime, roja kufitare mund t'i kërkojë që të paraqesë prova për statusin e tij duke treguar dokumentet e përshtatshme, në veçanti certifikata të lëshuara nga shteti akreditues ose një pasaportë diplomatike ose mjete të tjera. Nëse roja kufitare ka dyshime, në raste urgjente, ai mund t'i drejtohet direkt Ministrisë së Punëve të Jashtme.

4.3. Anëtarët e akredituar të misioneve diplomatike dhe përfaqësive konsullore dhe familjet e tyre mund të hyjnë në territorin e shteteve anëtare duke paraqitur kartën e përmendur në nenin 19, paragrafi 2 dhe dokumentin që i autorizon ata që të kalojnë kufirin. Gjithashtu, duke deroguar nga neni 13, rojat kufitare nuk mund t'i refuzojnë mbajtësve të pasaportave diplomatike, zyrtare ose të shërbimit hyrjen në territorin e shteteve anëtare pa u konsultuar më parë me autoritetet kombëtare përkatëse. Kjo zbatohet edhe kur për këtë person është regjistruar një njoftim në SIS.

4.4. Dokumentet e lëshuara nga organizatat ndërkombëtare për qëllimet e specifikuar në pikën 4.1 janë në veçanti sa më poshtë:

— Leje kalimi i Kombeve të Bashkuara që lëshohet për stafin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë e kësaj organizate në zbatim të Konventës për Privilegjet dhe

Imunitetet e Agjencive të Specializuara, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më 21 nëntor 1947 në Nju-Jork,

— Leje kalimi nga Komuniteti Evropian (KE),

— Leje kalimi nga Komuniteti Evropian i Energjisë Atomike (Euratom),

— certifikatë legjitimiteti e lëshuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës,

— dokumentet e lëshuara sipas paragrafit 2 të nenit III të marrëveshjes ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut Verior në lidhje me statusin e forcave të tyre (karta identiteti ushtarake të shoqëruara me një urdhër udhëtimi, ose një urdhër lëvizjeje individual ose kolektiv) si edhe dokumentet e lëshuara në kuadër të Partneritetit për Paqe.

## 5. Punëtorët ndërkufitarë

5.1. Procedurat për kontrollin e punëtorëve ndërkufitarë rregullohen nga rregullat e përgjithshme për kontrollin kufitar, në veçanti nenet 7 dhe 13.

5.2. Duke deroguar nga neni 7, punëtorët ndërkufitarë që janë të njohur nga rojat kufitare për shkak të kalimit të shpeshtë të kufirit në të njëjtën pikë të kalimit kufitar dhe të cilët, nga një kontroll fillestar, nuk kanë rezultuar të jenë subjekt i një njoftimi në SIS ose në një skedar kombëtar të të dhënave, i nënshtrohen vetëm kontrolleve të rastësishme për t'u siguruar se ata zotërojnë dokumente që i autorizojnë të kalojnë kufirin dhe përmbushin kushtet e nevojshme të hyrjes. Këtyre personave u bëhen verifikime të imtësishme herë pas here, pa paralajmërim dhe në intervale të çrregullta.

5.3. Dispozitat e pikës 5.2 mund të mbulojnë edhe kategori të tjera të udhëtarëve të rregullt ndërkufitarë.

## 6. Të miturit

6.1. Rojat kufitare i kushtojnë vëmendje të veçantë të miturve, të cilët udhëtojnë të shoqëruar ose të pashoqëruar. Të miturit që kalojnë një kufi të jashtëm në hyrje dhe në dalje i nënshtrohen verifikimeve të njëjta me të rriturit, siç parashikohet në këtë rregullore.

6.2. Në rastin e të miturve të shoqëruar, roja kufitare verifikon nëse personat që shoqërojnë të miturit kanë kujdestari prindërore ndaj tyre, në veçanti kur të miturit shoqërohen vetëm nga një i rritur dhe ka arsye serioze për të dyshuar se mund të jenë hequr në mënyrë të paligjshme nga kujdestaria e personave që ushtrojnë ligjërisht kujdesin prindëror ndaj tyre. Në këtë rast, roja kufitare kryen një hetim të mëtejshëm për të zbuluar ndonjë pasaktësi ose mospërputhje në informacionin e dhënë.

6.3. Në rastet kur të miturit udhëtojnë të pashoqëruar, rojat kufitare sigurohen, nëpërmjet verifikimeve të imtësishme të dokumenteve të udhëtimit dhe dokumenteve mbështetëse, që të miturit nuk po largohen nga territori kundër dëshirës së personave që kanë kujdesin prindëror ndaj tyre.

---

SHTOJCA VIII





- 
1. Opinioni i Parlamentit Evropian i 23 qershorit 2005 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Këshillit i 21 shkurtit 2006.
  2. *Gazeta Zyrtare L 239, 22.9.2000, f. 19.* Konventa e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 1160/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 191, 22.7.2005, f. 18*).
  3. *Gazeta Zyrtare C 313, 16.12.2002, f. 97.* Manuali i Përbashkët i ndryshuar nga Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2133/2004 (*Gazeta Zyrtare L 369, 16.12.2004, f. 5*).
  4. Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 2007/2004 e 26 tetorit 2004 për themelimin e Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian (*Gazeta Zyrtare L 349, 25.11.2004, f. 1*).
  5. *Gazeta Zyrtare L 374, 31.12.1991, f. 4.* Rregullore e ndryshuar së fundmi me Rregulloren (KE) nr. 1882/2003 e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (*Gazeta Zyrtare L 284, 31.10.2003, f. 1*).
  6. *Gazeta Zyrtare L 184, 17.7.1999, f. 23.*
  7. *Gazeta Zyrtare L 239, 22.9.2000, f. 69.*
  8. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 36.*
  9. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 31.*
  10. *Gazeta Zyrtare L 176, 10.7.1999, f. 53.*
  11. Vendimi i Këshillit 2004/849/KE, datë 25 tetor 2004, "Për nënshkrimin në emër të Bashkimit Evropian dhe për zbatimin e përkohshëm të disa dispozitave të marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane në lidhje me përfshirjen e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 368, 15.12.2004, f. 26*).
  12. Vendimi i Këshillit 2004/860/KE, datë 25 tetor 2004, "Për nënshkrimin në emër të Bashkimit Evropian dhe për zbatimin e përkohshëm të disa dispozitave të marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, Komunitetit Evropian dhe Konfederatës Zvicerane në lidhje me përfshirjen e Konfederatës Zvicerane në implementimin, zbatimin dhe zhvillimin e tërësisë së legjislacionit të Shengenit" (*Gazeta Zyrtare L 370, 17.12.2004, f. 78*).
  13. *Gazeta Zyrtare L 131, 1.6.2000, f. 43.*
  14. *Gazeta Zyrtare L 64, 7.3.2002, f. 20.*
  15. *Gazeta Zyrtare L 158, 30.4.2004, f. 77.*
  16. *Gazeta Zyrtare L 157, 15.6.2002, f. 1.*
  17. *Gazeta Zyrtare L 81, 21.3.2001, f. 1.* Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 851/2005 (*Gazeta Zyrtare L 141, 4.6.2005, f. 3*).
  18. *Gazeta Zyrtare L 64, 7.3.2003, f. 1.*
  19. *Gazeta Zyrtare L 53, 23.2.2002, f. 4.*
  20. *Gazeta Zyrtare L 239, 22.9.2000, f. 73.*
  21. *Gazeta Zyrtare L 116, 26.4.2001, f. 5.* Rregullore e ndryshuar me Vendimin 2004/927/KE (*Gazeta Zyrtare L 396, 31.12.2004, f. 45*).
  22. *Gazeta Zyrtare L 261, 6.8.2004, f. 119.*
  23. *Gazeta Zyrtare L 261, 6.8.2004, f. 36.*
  24. *Gazeta Zyrtare L 369, 16.12.2004, f. 5.*
  25. Për Norvegjinë dhe Islandën nuk kërkohet asnjë logo.
  26. *Gazeta Zyrtare L 187, 10.7.2001, f. 45.*
  27. *Gazeta Zyrtare L 355, 30.12.2002, f. 1.* Rregullore e ndryshuar nga Rregullorja (KE) nr. 849/2004 (*Gazeta Zyrtare L 158, 30.4.2004, f. 1*).
-